

ALBANIAN POST

**Nr.
84**

**GUSHT /
AUGUST
2025**

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 -

contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com



20 Avokati...



04 Somborka...



09 Mish Halal...



19 Modeli...

RIKTHIMI PAS PUSHIMEVE

Pas pushimeve të verës, rikthimi nga shtëpia ose vendlindja mund të jetë vërtet i vështirë. Ka shumë njerëz që përjetojnë depresion pas udhëtimeve të verës. Sot, shumica prej jush me siguri i kanë mbyllur pushimet e kësaj vere dhe rikthehen në Britani të Madhe. Nëse për ju kthimi në punë dhe në rutinën e përditshme është paksa i vështirë, po ju tregojmë disa hapa se si ta kaloni sa më lehtë këtë periudhë:

Dilni me miqtë

Miqtë janë zgjidhja në çdo situatë. Sa herë ndiheni të mërzitur, por edhe në rastin kur ktheheni nga pushimet, miqtë janë personat e...

(vijon në faqen 02)



SUPERMARKETI I SHQIPTARËVE

HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi i shqiptarëve në Kilburn High Road. Aty ku nën drejtimin e biznesmenit Mahmut Siringul do të gjeni të gjithë produktet e cilësisë lartë dhe me çmime konkurruese.



KUALITET - CILËSI

02073721059

22-324 Kilburn High Road, NW6 2QN

MIRË SE VINI!

WWW.FJALAEIREF.COM

(vijon nga faqja 01) ...duhur që duhet të telefononi. Mos qëndroni në shtëpi, por dilni sa më shumë me miqtë, derisa humori juaj të stabilizohet. Shtrenjtohen pushimet, shpenzimet ditore për ushqime dhe transport në rritje, problem pastërtia.

Kujdesuni për veten

Zakonisht, njerëzit me pushime qëndrojnë të lirë nga "pispillosja" e tepërt: pra, janë më natyralë, vishen me thjeshtë dhe vajzat preferojnë të qëndrojnë pa grim. Mirëpo, kur të ktheheni në jetën e përditshme duhet të filloni sërish të kujdeseni për pamjen tuaj.

Mos u ktheni direkt në punë

Shumica e njerëzve, menjëherë pas pushimeve kthehen në punë. Ajo çfarë ju sugjerojmë ne është të pushoni qoftë edhe 2 ditë në shtëpi, pas kthimit nga udhëtimi. Këto dy ditë do t'ju ndihmojnë për të kuptuar

se pushimet kanë mbaruar dhe duhet t'i riktheheni jetës së përditshme.

Planifikoni pushimet e radhës

Nëse ka diçka që na bën të ndihemi mirë është: planifikimi i pushimeve të radhës. Sapo të ktheheni nga pushimet, mendoni se cilin vend do të vizitoni më pas. Kjo gjë do t'ju gëzojë dhe t'ju motivojë që të riktheheni në punë më me vullnet

Restoranti i munguar modern i shqiptarëve

02089047775

DY MINUTA NGJA UNDERGROUNDI PRESTON ROAD

Web: www.rashidandrashidsolicitors.com



- KËSHILA LIGJORE FALAS
- SPECIALIST I AZILIT TË TRAFIKIMIT NJERËZOR
- DOKUMENTE UDHËTIMI
- PROCEDURA PËR LEJE QËNDRIMI
- ZGJATJE VIZASH
- LEJE PUNE RISHIKIM JURIDIK
- APLIKIM TRIBUNALI
- RASTET E TRASHËGIMISË

ZYRA QENDRORE:



020 8540 1666
020 8672 0666

190 Merton High Street
South Wimbledon
London
SW19 1AX

INTEGRITET - SINQERITET



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

KËSHILLA LIGJORE FALAS

Specialist i azilit
të trafikimit njerëzor



- ✚ Dokumente udhëtimi
- ✚ Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- ✚ Apelim Tribunali

Shërbime profesionale

ÇFARË OFROHET

Kur jeni
kontigjent për t'u
riatdhësuar, ose
të ndaluar nga
organet e
emigracionit

Mbulojmë të
gjitha aspektet e
emigracionit

Rastet e
trashëgimisë dhe
të gjitha
procedurat e
nevojshme ligjore

Zgjatje vizash,
leje pune,
rishikim juridik e
mjaft të tjera.

KONTAKTO

24/7

ORË LINJË EMERGJENCE

MOB. 0777 4222 062
078 78335 000

Rashid and Rashid Solicitors po rikthehet më profesional, më
i fuqishëm, dhe më i dedikuar profesionalisht, pasi Gjyqi i dha
të drejtën Ligjore.

INTEGRITET

Shërbim profesional, ligjor
dhe mbrotje e garantuar

WEBSITE

www.rashidandrashidsolicitors.com



ZYRA QENDRORE

190 MERTON HIGH STREET - SOUTH
WIMBLEDON - LONDON - SW19 1AX


TELEFONAT E KONTAKTIT



020 8540 1666
020 8672 0666

SPECA SOMBORKA – TASHMË ME SHUMICË TEK HILALL FOOD CENTER

Sivjet ka sardhur në ndihmë një kualitet më i mirë i specave somborka nga fushat e Kosovës. Dhe ky është dhe në një Njoftim për fermerët dhe bizneset në Kosovë lidhur me grumbullimin e produkteve bujqësore: “Të nderuar, me shumë kenaqësi ju njoftojmë se nga data 15.07.2025 fillojmë me grumbullimin e specave somborka, babure, si dhe pemëve e perimeve të freskëta. Pika grumbulluese: Rahovec, Sopniq. Të gjithë të interesuarit për bashkëpunim janë të mirëpritur te na kontaktojnë tani.” Kohë më parë Drejtoresha e Bujqësisë Lirie Hoti vizitoi disa fermerë. Në kuadër të angazhimit për të mbështetur fermerët llapjanë dhe për të ndjekur nga afër zhvillimin e sektorit të bujqësisë në komunën tonë, Drejtoresha e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Lirie Hoti, realizoi disa vizita



tek fermerë të ndryshëm në Komunën e Podujevës. Vizita e parë u realizua në fshatin Batllavë, tek fermeri Florim Statovci, përfitues i një serre prej 5 ari nga komuna. Fermeri Statovci është i angazhuar në kultivimin e grurit, misrit, specave paprika dhe somborka, si dhe rritjen e pemëve të mollës. Në vijim të vizitave, drejtoresha Hoti ndaloi në fshatin Orllan tek fermeri Enver Derguti, një fermer i dalluar i cili kultivon grurë, misër, patate dhe fasule, si dhe mban një numër të konsiderueshëm të deleve dhe lopëve qumështore

dhe bletëve. Gjithashtu, drejtoresha i vizitoi edhe fermerët Fahrudin Mahmuti nga fshati Siboc i Epërm dhe Albin Rrahimi nga fshati Balloc, të cilët janë kultivues të kulturave të ndryshme bujqësore. Drejtoresha Hoti i përgëzoi të gjithë fermerët për punën e tyre të palodhur dhe përkushtimin në zhvillimin e bujqësisë. Ajo i inkurajoi ata që të vazhdojnë aktivitetet e tyre me përkushtim dhe profesionalizëm, duke theksuar se komuna do të vazhdojë mbështetjen për ta.

Road! Rifurnizimi i radhës vjen javën tjetër. Nëse nuk arritët t'i merrni këtë herë, na shkruani ose na telefononi për të rezervuar sasinë që dëshironi. Për shkak të kërkesës së madhe, po zgjerohemi edhe në kohë të tjera ndërmjetëse për të përmbushur kërkesat e bashkatdhetarëve tanë kudo që janë në Britani të Madhe, thuhet në një bisedë nga pronarët e Hilall Food Center! Kontratat për shitje me shumicë kanë filluar – jemi gati për bashkëpunime në çdo pjesë të Mbretërisë së Bashkuar! Na kontaktoni për porosi dhe bashkëpunim afatgjatë.

DIREKT NGA FUSHA

Fushat e Kosovës

Për shkak të kërkesës së madhe, po zgjerohemi edhe në kohë të tjera ndërmjetëse për të përmbushur kërkesat e bashkatdhetarëve tanë kudo që janë në Britani të Madhe, thuhet në një bisedë nga pronarët e Hilall Food Center! Kontratat për shitje me shumicë kanë filluar – jemi gati për bashkëpunime në çdo pjesë të Mbretërisë së Bashkuar! Na kontaktoni për porosi dhe bashkëpunim afatgjatë.

- Somborka
- Domate
- Tranguj
- Perime

HILALL FOOD CENTER

High Road Kilburn

Direkt nga Fushat e Kosovës

- Somborka
- Domate
- Tranguj
- Perime

TË FRESKËTA

Më tej thuhet se nga zemra ju falënderojmë për besimin dhe përkrahjen që i dhatë prodhimit nga Mamusha. Domatet e freskëta dhe specat Somborka nga Mamusha, Kosovë po shiten në kohë rekord tek Supermarketi Hilall Food Center në Kilburn High

SOMBORKA

NGA FUSHAT E KOSOVËS

LETËRSIA SHQIPTARE, E SHKRUAR DHE E LEXUAR (?) RRETH BOTËS

Disa herë i jam drejtuar letërsisë, jo pak herë jam munduar që të thellohem në temën e letërsisë shqiptare, sidomos të asaj letërsie shqiptare, që prej vitesh po krijohet në botë dhe çdo herë kam ndjerë një hendek në atë që sot trajtohet rreth letërsisë shqiptare në tekstin letrar të saj në shkolla, institucione, mjedise letrare dhe Universitet. Vetëm kohë më parë, shkrimtarët shqiptarë e panë veten e tyre nën emrin e Robert Elsie të dilnin në një hapësirë më të gjerë. Edhe kjo me mënyrën se si ajo u përkthye. Ndërsa përcaktimi i Elsie shqyrton aspekte dhe manifestime kryesore të letërsisë shqiptare nëpërmjet peizazhit letrar global, si nismë duhet respektuar, pasi që bashkon në anglisht perspektivat e shkrimtarëve, përkthyesve dhe studiuesve të shquar të letërsisë dhe kulturës shqiptare, për aq sa ai kishte mundur të kishte dhe të mblidhte informacion në Shqipërinë letrare në

tranzicion. Sidoqoftë ndërhyrja e Elsie, në një përmbledhje të pritur ende prej kohësh identifikon korrelacionet midis ideologjive estetike kombëtare dhe botërore dhe traditave letrare. Ai e vendos letërsinë shqiptare brenda një sërë kontekstesh dhe nxjerr në pah një ndërveprim

kompleks të forcave të brendshme dhe të jashtme në ndryshim. Këto forca formësuan jo vetëm përpjekjet e para bashkëpunuese në fillim të shekullit të 20-të për të futur letërsinë shqiptare në thesarin letrar botëror, por edhe punën e shkrimtarëve bashkëkohorë shqiptar...

Kjo është ajo që pyes më së shumti veten ndërsa lexoj „Letërsia shqipe: një histori e shkurtër“ (Robert Elsie. Shqipëroi: majlinda Nishku.

Shtëpia botuese: Skanderbeg Books Viti i botimit 2006, Tirana. Faqet e librit 208), kushtuar fenomeneve të parë si letërsi që filloi vonë në krahasim me të Tjerët. Botimi është një hap shumë i rëndësishëm në njohjen ndërkombëtare të letërsisë shqiptare. Dhe sikurse citohet „Vëllimi „Letërsia shqipe: një histori e shkurtër“, orvatet të mbushë këtë zbrazëti, duke bërë një përshkrim të përmbledhur të zhvillimit të të shkruarit krijues në gjuhën shqipe. Ai përqendrohet tek autorët dhe rrymat më kryesore të letërsisë shqipe, që prej teksteve më të hershme në shekujt e trembëdhjetë, pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë, deri tek fillimi i mijëvjeçarit të ri, dhe është shkruar duke pasur parasysh një lexues të zakonshëm, që mund të mos ketë shumë njohuri në këtë fushë. Si i tillë, libri mund të jetë i dobishëm si udhëzues për të gjithë ata, fushat e interesit të të cilëve përfshijnë



kulturat ballkanike, letërsinë e krahasuar dhe historinë e kulturës evropiane në përgjithësi.“

Nga ana tjetër, kur them të Tjerët, konsideroj Ballkanin e afërt, dhe ndërmend mbetet ajo që pyes veten ndërsa lexoj „Letërsia Bullgare si Letërsi Botërore“, e përfshirë në serinë autoritare të redaktuar nga Thomas O’Beeby, kushtuar fenomeneve të parë si letërsi botërore. Botimi është një hap shumë i rëndësishëm

në njohjen ndërkombëtare të letërsisë bullgare. Për sa i përket dizajnit dhe strukturës së tij, libri prek aspekte kronologjike dhe tematike të letërsisë bullgare, të mbledhura në një mozaik kuptimplotë tekstesh nga shkrimtarë bullgarë dhe të huaj me një prani të dukshme si kritikë, përkthyes dhe shkrimtarë. Fakti që botimi është në anglisht, ofrohet me një bibliografi të botimeve të përkthyer dhe një indeks emrash është gjithashtu i rëndësishëm. Tek Letërsia shqiptare natyrisht përveç të tjerave që do të mbeten një hapësirë debati, mbetet sa realiteti, po aq „fati“ dhe fakti... Zakonisht, vështirësitë që prekin atë që ngec, jo thjesht në vëzhgimet e mia, por në faktet e anashkaluara në mjedisin shqiptar, mbesin në literaturën e “emigracionit” (me ose pa thonjëza) nga periudhat më të hershme të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe sidomos ato që tashmë kanë marrë me vete pasojën e “rrënies

së Murit të Berlinit”. Dhe pastaj. Ka një traditë të tillë që ekziston në variante të ndryshme, (trajtimet e njohura të veprave të

trajtesë. Unë do të përpiqem për të shënuar disa prej këtyre pyetjeve, jo shteruese, ndoshta dhe me pak shtjellim - për çdo përgjigje të caktuar.

Çështja e parë dhe me sa duket më e dhimbshme është dinamika e procesit dhe natyrës së emigrimit të regjistruar diku tjetër tej faqeve të letërsisë. Dhe çfarë është “diku tjetër”. Pavarësisht nëse në shekullin e 19-të “shqiptarizma” ishte kudo tjetër. Kudo tjetër në çdo kohë ajo lind edhe me lindjen e letërsisë “diku tjetër”. Letërsia shqiptare është krijuar në Turqi, në Evropën Lindore, Ballkanin e shtratit të saj, Evropën Qendrore, Amerikë, Egjipt, por jo edhe aq në territorin e vet etnik, dhe në vendet ku termi “emigrim” zuri vend deri më vonë. Në dekadat e fundit tendenca në mesin e termit “diku tjetër” për të mos botuar tekste synon jo thjesht të jetë pjesë e kulturës shqiptare, jo thjesht që me sa duket nevojitet për aq sa mund të shkruhet dhe të ruhet, por si një pasuri e padiskutueshme, e domosdoshme. Ndërkohë sot artistët shqiptarë punojnë gjatë turneve të ndryshme (natën dhe ditën) jashtë vendit dhe shkruajnë e botojnë tekste të veçanta që janë shkruar direkt si në gjuhën e bukur shqipe, edhe në gjuhë të tjera, dhe të botuara pra “diku tjetër”.

E dyta është për autorët. Emigrantët politikë dhe emigrantët ekonomikë janë kategori relativisht të qarta. Karakteristike e fenomenit “tamizdat” (tekste të shkruara në shtëpi, por tekste të botuar edhe jashtë vendit) praktikisht mungon si një pasqyrë realiste e institucionit shqiptar. Më i komplikuar për mua është rasti me diasporën tradicionale, i cili në këtë kohë të tranzicionit alla-shqiptar, dhe ndoshta pak më parë, ka intensifikuar harresën. Disa nga lëvruarit e letërsisë së shkruar botojnë në gjuhën shqipe, të tjerët janë të përkthyer...

shkrimtarëve shqiptarë) këtu do t’i anashkaloj shembujt. Rënia e Murit të Berlinit tashmë ka revokuar përfundimisht “emigrantin” në natyrën e letërsisë së shkruar nga shqiptarët e të gjitha trojeve etnike në vende të tjera. Dhe natyrisht këtu pyetjet janë të shumta. Dhe shumica e pyetjeve mbeti, ashtu sikurse nisi në vitin 1992 dhe ashtu sikurse dhe u shfaqën të reja në këto vite të një tranzicioni tipologjik dhe në mentalitet e

DR. SHPRESA FUNDO GJERGJI: “LUTJE PËR SHI”, E FATMIR TERZIUT, JO THJESHT NJË POEZI...

“Lutje për shi”, e Fatmir Terziut, është një poezi moderne, me imagjinatë e gjuhë të pasur, me metafora të shumta që bashkojnë elementë historikë, kulturorë dhe natyrorë. Tabloja poetike, që kjo poezi prezanton, është një atmosferë poetike e ndërtuar edhe me ngarkesë simbolike dhe ironike.

Tema dhe mesazhi:

Që në titull, edhe në thelb, zbulohet se poezia trajton pritjen e shiut, por kjo “lutje” zgjerohet përtej një dëshire klimatike. Ajo, në mënyrë sa të rrjedhshme e të natyrshme, aq edhe të sofistikuar, fillimisht të duket se bëhet një lutje për freski, për pastrim, për qetësim shpirtëror. Në një mjedis të ngarkuar nga zhegu, nga zjarret reale. Por nëse vështirimi analitik sheh brenda metaforizmit që ajo mbart, ndjen se nevojitet një ndërhyrje shpëtimtare, dhe kjo ndërhyrje kërkohet përmes metaforës së shiut.

2. Gjuha dhe stili:

Poeti përdor një gjuhë të ngarkuar me figuracion, ku përshkrimet janë surrealistike dhe shpeshherë edhe ironike. Lind pyetja në ç’mënyrë, si trajtohet kjo?!

Gladiatorët, historikisht, përfaqësojnë figura heroike, burra të armatosur që luftojnë me dinjitet e krenari.

Këtu Terziu i përshkruan me tipare si “të çmendur”, në pasazh (jo në betejë), dhe më qesharakja, “pa pantallona”. Pra ka një thyerje të pritshmërive, te vargu “retë gladiatorë të çmendur... pa pantallona”, krijon një efekt humoristik dhe absurd.

- Personifikimet janë të theksuara: retë, dielli, kalldrëmet, kanarinat, në se vëmendja kërkon ti shohë,

të gjitha marrin veprime dhe qëllime njerëzore.

3. Lidhja me realitetin dhe historinë:

Referencat si Egnatia, Namazgjaja, Kalaja, Shkumbini, e veshin poezinë me një bazë toponimike shqiptare, duke e vendosur veprimin në një realitet të njohur, por të mishëruar në simbolikë.

- Mënyra si vetë historia ndërthuret me përditshmërinë, tregon një dialog mes të shkuarës dhe aktualitetit, ku rrënojat dhe vendet e shenjta nuk janë më të shenjta, por të zbuluara, të ekspozuara, si “të zëna në faj”.

4. Simbolika dhe kontrastet

Zjarri dhe shiu, dielli dhe reshjet, zjarrfikësit dhe kalldrëmet, krijojnë kontraste të forta, që mund të lexohen si konflikte mes njeriut dhe natyrës, mes modernitetit dhe trashëgimisë, ose mes shpirtit dhe shterpësisë shpirtërore.

- Përmend këtu “Lutja për shi shprishet” e në fund sugjeron një dështim të lutjes, ndoshta për shkak të një realiteti që nuk ndryshon me dëshirë, por ka nevojë për veprim.

4. Gjuha jo e drejtëpërdrejtë dhe funksioni i saj në poezi

Do të dëshiroja të ndalesha sa do pak te gjuha e figurshme dhe poetike në poezi, e cila ka brenda nëntekstin poetik.

- Poeti duke përdorur personifikime, metafora, simbole dhe imazhe të befta, bën që gjuha e nënkuptuar mes tyre, të mbart më shumë kuptime sesa mund të thuhet me fjalë të thjeshta.

Konkretisht:

“Retë veshin taka të larta”, është një metaforë befasuese që krijon një imazh elegant,

por të çuditshëm edhe të huaj për natyrën. Është një përmbyse ironike që shenjton edhe artificialitetin në një botë që ka humbur natyrshmërinë. Pra duket qartë se nënteksti poetik flet me gjuhë “terziane”, një veçanti e spikatur e poetikës së autorit.

“Kalldrëmet e Egnatias... thërrasin zjarrfikësit” – rruga historike “flet”, kërkon ndihmë... vërejmë ngultazi një figurë që përçon gjendjen alarmante të historisë së harruar api të përflakur.

Konteksti është më i gjerë se fjala

Kjo gjuhë i jep lexuesit më shumë se një histori mbi zheg dhe pritje për shi. Në të vërtetë, ajo nënvizon një krizë më të thellë, atë shoqërore, kulturore, mjedisore, madje edhe shpirtërore.

Pra, fjala “shi” bëhet simbol për pastrim, për zgjidhje, për shpresë, ndërsa zjarret e përmendura (fjalë për fjalë ose metaforikisht) janë shenjat e rrënimt. Këtu, absolutisht merr vlerë konteksti i cili sjell poetikisht një tablo në përmasa më të gjera.

5. Çfarë vlere ka kjo për lexuesin?

Së pari do të thoja që kjo poezi sfidon interpretimin:

Një gjuhë e tillë poetike me dimensione të thella sociale, kulturore (siç e kam theksuar edhe herë të tjera, vjen nga vet formimi kulturor e akademik brilant i autorit - kemi të



bëjmë me një autor të madh, personalitetet me përvoja të shkëlqyera për letërsinë dhe kulturën shqiptare në dekadën e fundit), e cila e detyron lexuesin të ndalojë, të mendojë dhe të zbërthejë kuptimin. Kjo krijon një marrëdhënie më aktive me tekstin ku lexuesi nuk është vetëm konsumator, por bashkëkrijues i kuptimit të asaj që lexon e percepton intelektualisht.

2. Thellësia emocionale dhe intelektualiteti poetik

Fjalët, vargjet, frazat që në pamje të parë duken të çuditshme apo të pabesueshme, në të vërtetë krijojnë emocione të reja. Ato shpesh prezantohen si të përziera, që nuk do të mund të ngjallehin me një shprehje të thjeshtë e të drejtëpërdrejtë.

“Lutje për shi”, është një poezi e gjallë, e ndjeshme dhe jo vetëm kaq. Ajo shpesh është edhe tronditëse. Sepse pikërisht kjo veçori e fjalëve, vargjeve dhe frazave që duken të çuditshme apo të pabesueshme, është ajo që shërben për të krijuar emocione të reja dhe të pazakonta. Emocionet njerëzore janë të përziera dhe jo lineare...

INTERVISTA: FLET SHKRIMTARI NEHAS SOPAJ

1 Do të filloj me librat tuaj të fundit të botuar. Cila është gjëja më e rëndësishme që ideoet në librat tuaj? Mediat theksojnë se këto botime përbëjnë një ngjarje të veçantë kulturore dhe letrare, duke ndriçuar më tej veprën tuaj me kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e poezisë, prozës, dhe kritikës shqiptare. Ju si mendoni me pak fjalë?

- Të falënderoj shumë mik për konsideratën që ke për mua, miqësia jonë e moçme, sa po më "ledhaton", nga ana tjetër kjo gjë po më bën paksa të ndjem keq për shkaqe të ndryshme. Sepse, të krijosh letërsi dhe studime si rasti im, nuk është ndonjë privilegj si mund ta mendojë dikush, sepse sot të krijosh në vendlindje, i tërhequr nga opiniononi, kjo nuk don të thotë se e ke gjetur qetësinë për krijimtari, po përkundrazi, kjo don të thotë të kesh më shumë armiq sesa miq, të të bëjnë "helaqe" mu ata që s'i ke dijtur për të tillë. Sepse, në atmosferën përherë nebuloze dhe të disekuilibruar kulturore shqiptare te ne, veprat e krijuesëve vazhdojnë të mbeten të pavërejtura nga opinion public relevant. Sa u përket veprave të mia, duhet thënë se lexuesit e dinë se brenda këtyre dy dekadave të fundit, në planin e veprave artistike, unë në fakt nuk kam sjellë gjë të re, por thjesht i kam "ritushuar", ripunuar dhe rikrijuar temat dhe motivet e dikurshme që gjithë jetës i kam bërë, kështu që tre romanet me titull "Vallja e vdekjes së verdhë", lexuesi mund ta gjejë si një fakturë e re të shkrimit të veprave të tjera, parake, pra ato janë shkrimet mia të dikurshme, të bëra në fizionomi të re. Nga ana tjetër, e re për lexuesit, është vepra Individualitete letrare 1 - 30, që është teksti në të cilin është mbarështuar letërsia bashkëkohore shqipe; kjo është lënda e leksioneve të cilët i kam zhvilluar para

studentëve të mij me dekada derisa u pensionova.

2. Si duken sot me njëra-tjetrën letërsitë e krijuara në territoret e banuara me shqiptarë? Si e shihni Shqipërinë dhe letërsinë e saj nga disa kilometra larg, që në fakt nuk duhet konsideruar si largësi?

- Përgjigjen mund ta them në dy planëshe, në fillim në cilësi të krijuesit letrar dhe së dyti në cilësi të profesorit të lëndës letërsi bashkëkohore shqipe. Natyrisht, më me ëndje do të dëshiroja t'i përgjigjem pyetjes së parë, por meqë kësaj pyetjeje mund të pasojnë pyetjet e tjera që mund të pasojnë e që do të m'i shtrosh, le të përgjigjem kësaj të dytës. Letërsia shqipe e krijuar në të gjitha hapësirat shqipe, është një dhe e njëjtë, kudo që të zhvillohet ajo. Për më tepër se gjysëm shekulli, ç'prej se ekziston letërsia shqipe, ajo është zhvilluar e njëjtë si në Shqipëri, në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni. Shkrimi shqip ka qenë i njëjtë, pa marrë parasysh fizionomitë e tyre gjuhësore, me idioma të caktuara stilistike që nuk ia prishin shijen lexuesit. Hiq elementet e theksuar të soc-realizmit të periudhës komuniste, letërsia shqipe është po ajo, me fare pak dallime, por kjo, jo vetëm sepse është shkruar në një gjuhë të njëjtë. Sa larg të jetë kjo letërsi, si psh. ajo tek Arbëreshët e përtej adriatikut, pa marrë parasysh idiomat e theksura dialektore (disa madje e quajnë dialekt më vete), ajo është e njëjtë, sepse është shqipe edhe ajo.

3. Si e shohin kolegët tuaj dhe studentët letërsinë shqiptare sot? A është dukshmëria e dëmtuar në ndonjë këndvështrim dypalësh?

- Nuk jam shumë i sigurtë për mendim kolektiv, sepse secili mund të mendojë si të dojë,

por mesa ma merr mendja mua, besoj se edhe ata duhet ta mendojnë njëllë si edhe unë... Pyetjen më poshtë mund ta vëzhgojnë individët si të dojë akëcili.

4. Meqenëse kombinoni perspektivën e një shkrimtari me emër, një studiuesi dhe kritiku letrar dhe një poeti të mirënjohur, a vini re ndonjë të metë të pakapërcyeshme në letërsinë shqiptare që përsëritet periodikisht në epokë të ndryshme?

- Nuk e kam fort të qartë se ç'o doni të thoni me fjalën si të metë të pakapërcyeshme, por nëse e ke fjalën për karakterin gjuhësor të akëcilit krijues, ose ndonjë fenomen të caktuar të ndonjë krijuesi, atëherë unë do të orvatem të them se çka mendoj për çështjen. Gjuha shqipe është gjuhë e rrallë dhe ndër ato gjuhë që nuk ka simotër në botë dhe si e këtillë ka forcën e unikalitetit që me të tjerët komunikon dhe mund të vejë koleracion me mjetet e saj që poashtu është e veçantë dhe se si e tillë, ajo mund të komunikojë si edhe të gjitha gjuhët tjera të botës. Pastj, kahmot është thënë se disa krijues është vështirë të përkthehen, dhe nëse edhe ndodh edhe të përkthehen, përkthimi i tyre o bëhet i dobët, o humbin shumë nga origjinaliteti. Si shembull, studjuesit e kanë marrë për ilustrim Lasgush Poradecin. Ka mendime të ndryshme për të njëjtin kuptim, por ka edhe shkrimtarë, të cilët, thjesht nuk përkthehen. I këtillë është psh. Beqir Musliu, thjesht, për shkak të formacionit stilistik në të cilin është shkruar vepra e tij; secili lexues i cili e di stilin surrealist të Beqirit, e di se në përkthim surrealist i tij do një ndërbartje që vështirë se mund të bartet në qarkun tjetër gjuhësor tjetër, më saktë si mund të tingëllojnë mjetet e reja gjuhësore.



5. Çfarë mendoni për gjendjen letrare të sotme? A duhet fajësuar tranzicioni dhe e shkuara për diçka, për shembull?

- Si po e përfytyroj pyetjen unë, me frazën "gjendje e sotme letrare" e ke fjalën te zhvillimi i letërsisë sonë bashkëkohore që me solucionin "fajësim" tek tranzicioni dhe e shkuara, që dmth., se a ka ndodhur diçka në procesin normal të zhvillimit gjatë kontinuitetit. Me këtë pyetje, ma kujtove një moment të kohës së para tre dekadave kur ne në Katedër të Albanologjisë në Shkup, organizuam një simpozium të cilin e pagëzuam Kontinuitete (letrare, gjuhësore, folklorike, pedagogjike e tj.), një kohë kur sapo kish rënë komunizmi si ideologji, dhe, sado që akoma e gjallë ishte miniperandoria jugosllave dhe kur ne me kaq entuziazëm po e përqafronim tranzicionin... "Gjendja" për ne që ishim nën tutelën e jugosllavizmit, tek sivëllezërit tanë të Shqipërisë merrej krejt ndryshe nga ne "këtej", gjersa ne po merrnim frymë se po çliroheshim nga robëria e mirëfilltë millosheviqiane, i shihja te pala tjetër, të Shqipërisë pra, tek filluan të flisnin kundër soc-realizmi me shumë entuziazëm dhe patos... Kjo kohë tashmë ka kaluar, ka kaluar por nuk ka ndodhur ajo që ne të njëfemi definitivisht deri në fund si jemi, deri në palcë; mendoj se do të na duhet akoma kohë deri sa ta njofim mirë njeri-tjetrin...

ANAGRAMI I RILINDJES SHPIRTËRORE: “JEPJA POEZISË ATË QË I TAKON ASAJ”!

Unë erdha nga një vend i vogël me krijues të mëdhenj. Vij nga një brez që lexonte shumë. lexonte dhe poetët... Po poetët vetë lexojnë? ‘Poetët e mirë lexojnë shumë’, thotë poetja britanike, Uendy Cope. Pa dyshim kjo është një influencë për krijimtarinë e tyre, por si ata duhet të gjejnë se çfarë e bën një poet me një poezi vërtet të mirë?

Sot, si kudo, edhe në mjedisin poetik, të shkruarit, të lexuarit, por dhe të botuarit, është si në gjeografinë e një shteti që propagandohet i lirë, brenda terminologjisë „të lirë“, por që pa e kuptuar gjithësesi është një gjendje diskursive plotë anarki, ku natyrisht çdokush mund të lëvizë, të rivendoset, të gjej veteveten, dhe në këtë rast të shkruajë, e gjithkush mund të botojë, si të dojë e sa të dojë. Kaq tek shkrimi. Ndoshta jo aq pak tek leximi. Rëndësi ka që je. Rëndësi ka që dikush shkruan... Shkruan mirë?

Dhe nëse je, apo është dikush i interesuar për një të shkruar të mirë, në një detyrim poetik për tu lexuar, që të bëhet një poet i mirë, më e rrëndësishmja është ajo që vjen nga leximi. Leximi që mbetet pikë referimi. Ai leximi i një poezie të kohës. Ai leximi që vjen nga udha e gjatë. Ai leximi që tingëllon si poezi e shekujve të kaluar. Ja pra se si këshillohet, sot nga poetët më në zë të Perëndimit.

Në këtë formë të tillë thuhet se, lindi dhe u zhvillua vetë njeriu i leximit (nuk ka rëndësi ishte femër apo mashkull). Ky njeri i leximit, sikurse thuhet, duhet të kishte ardhur përreth rrjedhës së vetë poezive. Rrjedhës së tillë, ku një pikë natyrisht rreket në vetë konceptin e diskursit, në këtë kompleksitetin e

poezive, ku si gjithnjë e para ishte Fjala (Pra poezia është vetë Krijimi nga Krijuesi, është Fjala e Shenjtë, Rilindja e munguar Shpirtërore). Më saktë të vetë asaj, që Krjuesi e krijoi, dhe na afroi shijen që e perceptonte si poezi. Dhe në këtë rast pa pikë e pa presje, duhet thënë, se rrëndësia e disa poezive të mësuar në shkollë, nuk është e mjaftueshme dhe sot theksi i diskursit vendoset tek leximi i munguar i poezive.

Shihet edhe kjo e rrëndomtë: Kur dikush që urren leximin e poezive, dëshiron të shkruajë poezi?! Sa fatlum ndihet në vetevetë? Kushedi?! A ka dikush t’ia bënë të qartë se çalon në këtë risi? Po ai vetë a është në gjendje që ta di? A ka ndonjë piktor, qoftë dhe amator, që ka bërë pikturën e tij dhe kurrë nuk ka parë me imtësi, apo nuk ka lexuar se si funksionon piktura, qoftë dhe

„emrat“ e tillë, dhe vetë ‘poetët jolexues’. Nuk e kam për ata të palexuarit. Për ata që askush nuk i lexon, përveç rrjeteve sociale. Jo për ata. As për ata analistë që mprehin lapsin, sa herë që gjejnë rastin.

Në mjaft raste ‘poetët jolexues’ arsyetojnë mosleximin se ata kanë frikë, se mos influencohen nga të tjerët. Ata nuk e kuptojnë këtë se të jesh ‘i influencuar’ është një pjesë e procesit të shmangjes prej të mësuarit.

Dhe të influencuarit të mëson lirinë, të jep hapësirën të shprehësh realitetin. Dikur disa poezi të poetes Silvia Path në Britani, ashtu si disa letra të saj, përfunduan në mospublikim. Këto poezi dhe më së shumti letrat e papara të Sylvia Plath pretendonin abuzim në familje, ka shkruar Ted Hughes. Kësisoj korrespondenca e zbuluar më vonë dhe e pabotuar nga poetja me ish terapistin e saj regjistron pretendimin për rrahje dhe thotë se ai (protagonisti karakter i poezive) i tha asaj se do të donte që ajo të kishte vdekur.

Gradualisht jemi ndeshur edhe me mjaft raste të tilla leximi, mjaft ndikime, apo influencime të hapura nga një botë e tillë. Poetët e divorcuara shpërthejnë ndaj dashurive të tyre të para, poetët e ndarë nga e dashura shkruajnë ndonjë „përrallë“ e kështu poezi sillet si një diskurs i përdalë. Dhe në mjaft raste e kemi ndjerë një drithmë. E kemi bërë të ditur edhe për lexuesin, pra publikisht. Dhe në këtë rast tingëllohet si vetvetja në poezi, poeti mbetet i çliruar dhe lexuesi mbetet i ndriçuar nga çka i ndodh, apo mëson e ngase ndikohet a frymëzohet përditë... Pra në këtë mënyrë

ndodh vetë ndriçimi shpirtëror që krijon lexues dhe nxënës të përditësisë, para se të mbetesh lektor në profilin e tillë.

Gjykimi i tillë i poezisë ka përforcuar bindjen me një rëndësi të veçantë që lidhet me tonin e veçantisë së vetë krijimit poetik. Nëse një poezi është e lexueshme, pra të jetë e tillë, zëri në të duhet të tingëllojë si një zë i një personi, që flet nga influenca e gjërave, nga ndryshimi dhe ndriçimi dhe rilindja e tij shpirtërore. Kjo aplikon edhe vetë monologun dramatik (kur poeti fut fjalët e tij në gojën e një tjetri) apo edhe tek lirikën në vetën e parë.

Mjaft njerëz të pasigurtë përdorin një zë të kamufluar, apo të determinuar qëllimisht. Pra edhe në poezi nëse nuk je zëri yt, je dhe mbetesh një anonim. Pra je i panjohur. Poezia është e tillë. Shkruarit pa përvojë bëjnë të ngjashmen në krijimet e tyre, përdorin ‘gjuhë poetike’ që ata kurrë nuk e bëjnë atë të flasë vetëm si poezi, jo e jo, (mjafton të ketë rimë, apo vargëzim). Në disa raste e bëjnë klishe, pa konfidenca, apo energji të gjejnë veten, ose thjesht si një shpërthim vetvetor, në mjaft raste edhe pa lidhje. Pra me këtë mbetet një jo-poezi, thjesht krijhet por me këtë mbetet thjesht arsye ngarkuese dhe jo emocionale në një rast shkrimor.

Ndonjëherë një ndikim i tillë retorik kërkon realisht nga brenda vetvetes mjaft mënyra për të pyetur e për të ripytur: “A e ndjen poeti, krijuesi këtë sepse duhet ta ndjej, a e bën atë me gojë, që të flasë, apo e krijon në memecëri dhe ajo që krijon flet kuturu?”. T. S. Eliot thotë se më e vështira e një poeti është të bëjë krahasimin mes “çfarë dikush ndjen dhe çfarë duhet të ndjejë”. Për këtë, vetë T.S. Eliot, një nga fjalëbërësit më të mëdhenj në kujtesën e gjallë, tha një herë: „Emri im është vetëm një anagram tualetesh“...



me sy, dhe më tej bën vetëm mrekullira? Apo një muzikant (qoftë dhe amator) që bën muzikë (pa njerëz) mes pyllit? Ky është formati aneksues. Është formati që shmang lexues. Nuk kërkon shkruar. Është formati që ushqen vetëm botues. E në këtë rast vetë rasti e sjell që të ketë vetëm disa emra (qofshin meshkuj, qofshin femra), që botojnë se kanë mundësi dhe bëhen „emra“. Këtu hyjnë edhe poetët e palexuar. Ndoshta dhe poetët më në zë, por që i mbysin vetë

MISH HALLALL DHE TË KONTROLLUAR

Supermarketi Hilal Food Centre në High Kilburn Road, si mjaft të tjerë supermarkete në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar shërben mish hallall prej të gjithë kohëekzistencës së tij. Po çfarë është "Halal"? Në arabisht, fjala Halal do të thotë "e lejuar" ose "e ligjshme" dhe përcakton çdo gjë që është e lejuar ose e ligjshme sipas Kuranit. Shpesh përdoret në kontekstin e ushqimit

- veçanërisht mishit - për të treguar se ushqimi është përgatitur në përputhje me parimet dhe teknikat myslimane. Ligji i BE-së kërkon që kafshët për zinxhirin ushqimor të trullosen (të lihen pa ndjenja) para vrasjes, në mënyrë që vdekja të jetë pa dhimbje, megjithëse ekziston një përjashtim për therjen fetare.

Megjithatë, shumë restorante ende kërkojnë që therja Halal të përfshijë trullrosjen e parë, dhe shumica e therjes Halal në Mbretërinë e Bashkuar përfshin trullrosjen sipas RSPCA-së. Një raport nga organizata

bamirëse e kafshëve në vitin 2012 thotë se 90% e deleve dhe 97% e bagëtive të therura duke përdorur metoda Halal në Mbretërinë e Bashkuar u trullrosën së pari.

Një nga punonjësit e këtij supermarketi na tha: "Ne kërkojmë që të gjitha proceset e therjes për produktet me markën e supermarketit të përmbushin kërkesat tona të rrepta për mirëqenien e kafshëve, pa përjashtim. Në çdo rast, ne shesim

mish të markës, ose presim koncesione që shesin mish hallall të pa trullrosur. Kjo është për t'i shërbyer klientëve që dëshirojnë posaçërisht të blejnë mish të pa trullrosur. Ky mish është etiketuar qartë si Halal, në mënyrë që klientët tanë të jenë në gjendje të bëjnë zgjedhje të informuara. Mishi hallall preferohet për disa arsye, duke përfshirë rëndësinë fetare, konsideratat

mbi arsyet e preferencës së mishit hallall:

1. Rëndësia Fetare:

Ligjet Islame të të ngrënit:

Mishi hallall është një pjesë thelbësore e ligjeve islame të të ngrënit (Sheriati), i cili dikton se çfarë është e lejueshme për konsum.

Kuptimi Simbolik:

Konsumimi i mishit hallall shihet si një mënyrë për të ndjekur urdhërimet e Zotit

duke reflektuar vlerat islame të mirësisë dhe dhembshurisë.

Pa Vuajtje të Panevojshme:

Praktikat hallall synojnë të shmangin dëmin e panevojshëm dhe të sigurojnë që kafsha të jetë në një gjendje të shëndetshme para therjes.

3. Përfitimet e perceptuara shëndetësore:

Pastërtia dhe freskia:

Kullimi i plotë i gjakut gjatë therjes hallall mendohet se e

bën mishin më të pastër dhe më të freskët, me më pak konservues ose aditivë të nevojshëm.

Hormone të reduktuara të stresit:

Disa besojnë se procesi i therjes hallall, i cili shpesh shihet si më pak stresues për kafshën, çon në mish që është më i butë dhe më pak i fortë.

Pa hormone dhe pa antibiotikë:

Mishi hallall shpesh rritet pa përdorimin e hormoneve të rritjes ose antibiotikëve, gjë që mund të jetë shqetësuese për disa konsumatorë.

4. Faktorë të tjerë:

Certifikimi:

Mishi hallall shpesh certifikohet nga organizata me reputacion, gjë që i siguron konsumatorët se përmbush standardet dhe udhëzimet e kërkuara.

Disponueshmëria:

Mishi hallall po bëhet gjithnjë e më i disponueshëm në supermarkete, restorante dhe institucione të tjera ushqimore, duke i shërbyer një audience më të gjerë.

Shija dhe tekstura:

Disa njerëz e gjejnë mishin hallall të ketë një profil të dallueshëm shijeje, shpesh të përshkruar si më i butë dhe më i pastër se mishi konvencional.



HILAL FOOD CENTRE

MISH I KONTROLLUAR DHE



KUALITET

etike dhe përfitimet e perceptuara shëndetësore. Për myslimanët, është një kërkesë fetare dhe konsiderohet gjithashtu një opsion më human dhe etik, me udhëzime që sigurojnë që kafshët të trajtohen me respekt para therjes. Përveç kësaj, procesi i therjes hallall, i cili përfshin kullimin e plotë të gjakut të kafshës, besohet se kontribuon në mish më të pastër dhe më të shëndetshëm.

Ja një vështrim më i detajuar

dhe për të demonstruar devotshmëri.

2. Konsiderata Etike:

Trajtim Human i Kafshëve:

Praktikat e therjes hallall janë të dizajnuara për të minimizuar dhimbjen dhe vuajtjet për kafshën, shpesh të konsideruara si një qasje më etike sesa metodat konvencionale.

Dinjiteti dhe Respekti:

Procesi thekson trajtimin e kafshës me respekt dhe dinjitet, madje edhe në vdekje,



46 BIRCHINGTON ROAD
NW6 4LJ

Restoranti I SHQIPTAREVE

Restaurant Bar "Imperial"

"Shijoni shijet e pjatave tona të shkëlqyera, ku çdo
kafshatë tregon një histori të shijshme."



Kualitet

Dasma

Ne ju ndihmojmë në
perfeksion



Cilësi

Festime

Ju a bëjmë më festive
festën tuaj



Pastërti

Familjare

Ne jemi si një familje
ndaj e dimë
familjaren

Rezervo



020 7624 1385

EDUART BALA: PROFESIONALIZMI PËR DËRGESAT TUAJA

Ju njoftojmë se kompania që drejtohet nga Mondì, që është dhe mbetet kompania më e sigurtë dhe më profesionale e transportit të mallrave nga Anglia drejt Shqipërisë dhe anasjelltas, do të kryejë destinacionin e saj përkatës të radhës duke grumbulluar mallrat në datën 26 tetor 2023 në këto qytete britanike: Birmingham, Luton, Banbury, Oxford, Coventry, Northampton, Manchester, Leeds, Sheffield. Po ashtu ju njoftojmë se nisja e destinacionit përkatës nga Shqipëria drejt Anglisë bëhet në datën 5 Nëntor 2023. Për më shumë informacion kontaktoni drejtuesit e kësaj kompanie në celularin që jepet në fund të këtij shkrimi.

Mjaft kompani transporti e nisin me një slogan sikur janë qindra vjeçarë në këtë profesion të ri të tyre. Dhe më së shumti duan të theksojnë se kanë kryer dhe transporte të mëdha, kur dihet se si njëra dhe tjetra janë vetëm tentativa dhe lojëra fjalësh.

Kompania që drejtohet nga Eduard Bala (Mondì) mbetet më e saktë dhe me një eksperiencë të gjatë, natyrisht jo vetëm në Shqipëri dhe Angli dhe në destinacione të tjera ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe mjeteve të ndryshme, ofron për të gjithë klientët e saj një shërbim të kompletuar dhe sigurt transporti i destinuar mbetet prioriteti dhe profesionalizmi, besimi dhe konsiderata efikase.

Siguria, shpejtësia dhe garancia e punës së zhvilluar ndër vite ka bërë që sot shumë bashkëathetarë dhe miq, të tjerë të lidhur me Atdeun tonë të dashur dhe mjaft anglezë madje që kanë shkuar të

eksperiencia e saj dhe nga aktiviteti serioz, po aq dhe nga respekti, nga përkushtimi dhe përgjegjësia e plotë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të mallit deri në dorëzimin e tij në destinacionin final, mbetet

standarteve të një shërbimi transporti modern dhe efikas, me një garanci, mosprishje të mallrave, dhe me dërgimin pa probleme të tyre. Vizioni natyrisht mbetet qartë, të vazhdoj të mbetet një kompani lider i padiskutueshëm në transportin e Mallrave nga Britania e Madhe dhe vende të tjera të Europës drejt Shqipërisë dhe anasjelltas.

Kjo kompani funksionon me furgonë të posaçëm për këtë punë dhe me dy drejtues makinash të sprovuar në mjaft vende të huaja.

Nëse jeni duke kërkuar për një kompani cilësore, efektive, transparente, kompetente, të besueshme dhe profesionistësh, atëherë kjo është zgjedhja e duhur dhe e domosdoshme në çdo kohë.

Me këtë transport, e gjitha që ju dërgoni dhe prisni të merrni në destinacionin tuaj është në dorë të sigurtë dhe me garanci të plotë.

Duhet theksuar se mbi 50kg i marrin dhe i dërgojnë në destinacion.

Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet



TRANSPORT

ANGLI-SHQIPËRI

MALLRA DHE MATERIALE

SHPEJT

SAKTË - RESPEKT

TRANSPORT MALLRASH: ANGLI-SHQIPËRI & SHQIPËRI-ANGLI

Mbi 50kg i marrim dhe i dërgojmë në destinacion.

- **ANGLI:**
- +447395287400
- **SHQIPËRI:**
- +355 68 3676859

VLERA PROFESIONALE

SAKTËSI - KURSIM

RESPEKTI NDAJ KLIENTIT NA PROVONI



Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

investorë në Shqipëri, po aq dhe imigrantët që jetojnë, punojnë dhe studiojnë, prej shumë vitesh në Britani të Madhe dhe në Europë kanë ardhur në pikën më të mirë të mirëkuptimit të besojnë transportin e mallrave të tyre drejt Shqipërisë.

Duam të themi se kjo kompani e njohur tashmë nga

konkurrese dhe në çmime.

Ajo mund të kontaktohet në numrat e telefonit ose në WhatsApp, Viber, Facebook, Instagram dhe e-Mail për tu informuar mbi datat dhe lokacionet e grumbullimit dhe shpërndarjes së mallit. Misioni i kësaj kompanie është të vazhdoj rrugën e suksesit në vijimin dhe përmbushjen e

TRANSPORT MALLRASH: ANGLI-SHQIPËRI & SHQIPËRI-ANGLI

ANGLI: +447395287400

SHQIPËRI: +355 68 3676859

NJË TUFË POEZISH TËRHEQËSE

Një tufë poezish tërheqëse të dërguara para disa ditësh nga poeti shqiptar Lutfi Alia, më bën të shkoj më tej leximit. Më bëri kjo për vetë faktin se ky poet gati i 'braktisur' nga kritika shqiptare dhe po aq edhe nga mediat e kolegët, në një kohë që nga viti 2005 - 2010 ka marrë 21 çmime në konkurse ndërkombëtare dhe nacionale të poezisë, çmime për poezi dhe për vëllime me poezi. Ai është botuar në gjuhën italiane me disa vëllime të tilla si:

1. "Luna senese", Poesie - Nicola CALABRIA Edizioni. 2007 – Patti - Palermo
2. "Notturmo senese", Raccolta di poesie - BETTI Edizioni – 2006 Siena
3. "Tutto...in una notte senese", Poesie - VITALE – Edizioni, Sanremo 2005.
4. "Il vento d'amore senese" – Poesie, VITALE _Edizione. Sanremo 2008
5. "Le categorie etico-morali del Codice Consuetudinario albanese. Kanun di Lek Dukagini

(Saggistica) Edizione Albalibri - Milano 2009

Në fakt jashtë këtyre sukseseve dhe botimeve, më bën poezi të tilla si "Dritë spirale", "Ti je Sheherazadia ime", "Po të pres", "Flokët e tua", etj., të hyj në imagjinatën poetike, teorinë e ndërlikuar të Zigmund Frojdit dhe Martin Heidegerit. Dhe teksa lexoja me vëmendje këto poezi arsyeja dhe logjika më shpinte të shihja punën krijuese të Alia, në një temë, një ide: imagjinatën poetike.

Kështu analiza e ndërmarë më

diktoi të diskutojë marrëdhëniet në dialektikën mes krijimtarisë dhe realitetit, dy fenomene të para nën dritën e teorive të lartcituara. Ajo fillon me strukturat metapsikologjike të teorisë së Zigmund Frojdit rreth arsyes së shpjeguar në mënyrë teorike studimore rreth mendjes njerëzore. Këto koncepte janë të para më pastaj, ngushtë me vargun e perceptimin e poetit, në dialog me këndvështrimin e Martin Heideger-it. Ky diskutim i lidhur me këto teori, me thelb aspektin e imagjinatës poetike natyrshëm përfshin në kërkim elementin poetik, në jo vetëm ndikimin që kjo teori e bën nëpërmjet veprës së artit, por edhe mes strukturave metapsikologjike të poetit si artist. Në poezi të tilla si "Unë, Ti dhe Hëna", struktura metapsikologjike e poetit si artist është një formë semantike e vetës së parë: "A e kujton atë natë/kur filladi i puthjeve/i ngrohu shpirtat tonë /e nga lart hëna e fildishtë/hyri nga dritarja me dritën e zbehtë,/na njohu menjëherë/u befasua nga zjarri i dashurisë sonë/e turpëruar/iku të fshihej prapa reve."

Duke u kthyer së pari përmes teorisë të Frojdit, tek poezia tjetër "Sirena", ne gjejmë se imagjinata poetike dhe kreativiteti janë paraqitur në mënyrë tipike në aspektin e fantazisë, ëndërrat me sy hapur dhe nata e ëndërruar. Këto fenomene janë të lidhura me parimin kënaqësi. Frojdi thotë se imagjinata poetike është një formë e zëvendësimit dhe mund të shihet si në një lojë të fëmijërisë. Fantazia është lojëplotësi. Fantazia është potenciali i një të rrituri për të luajtur. Ajo përfshin një fluturim nga realiteti. Poezia "Një natë në Piza" paraqet këtë fantazi sërish në një

anatemë ku protagonist është autori dhe na shfaq një kontekst të ndryshëm motivues: "Mbuluar me dritë të butë/shkrihet Piza në rrugica vetmitare,/e shpërfillur/mbledh jehonën e hapave tona,/që të çakorduara shkelin mbi gurët e ftohtë. /Eshte një natë pa emer,/një natë e bukur,/e ne të dy/shetisim/ në rrugicat e zbrazëta,/ lidhur në intimitetin tonë të zakonshëm,/dora ime mbi supet tua/delikate/hëna mbi mal,/qielli i yllëzuar mbi krye/e me mendime që na nxisin të imitojmë,/ritualin e takimeve tona klandestine./Më vështron butësisht /kokën e mbështet mbi/gjoksin tim /ku zemra rreh me rrëmbim/puthja ime u ndal lehtë mbi gojën tënde, / piva dashuri nga buzët e tua/deri sa shuajta etjen për ty." Mes konceptit të Frojdit, këtu amorfia 'fëminore' e lojës si kopje është një vegim që secilit i vjen nga një kontekst i vendosur mes dëshirës. Nga ana tjetër, tashmë i rrituri i kësaj poezie, e di se çfarë pritet nga konteksti "të rriturit" dhe është i detyruar për këtë arsye nga parimi realitet të intrigojë me fantazinë dhe imagjinatën. "Të rriturit" si nocion i kësaj poezie në gjuhën e stilin e poetit ndërlikon më tej teksa 'duhet të mbajë disa dëshira sekret. Frojdi thotë se këto dëshira të fshehta rrjedhin nga kënaqësia dhe shpesh ndodhin mes strukjes, që në këtë rast mes vargjeve "kokën e mbështet mbigjoksin tim /ku zemra rreh me rrëmbim/puthja ime u ndal lehtë mbi gojën tënde, /piva dashuri nga buzët e tua/deri sa shuajta etjen për ty", dalin tej lojës së imagjinatës poetike.

Vetë Frojdi përdor veprat poetike për të ilustruar këtë proces. Ai mbështetet mbi shpalosjen e njohurisë



së poetit në drejtim të komplekseve psikologjike për të plotësuar lidhjet kryesore të poetit me punën e artit dhe lexuesit. Frojdi përdor një metodë të dyfishtë, duke përshkruar një metodë emocionale identifikimi. Ai sheh pikërisht këtë aspekt të 'vetëndërgjegjshëm', që ndodh me poetët dhe mesazhin e përvojën ndaj lexuesit të krijimtarisë së tij poetike. Këto, janë edhe komplekse që shpallen me artin e fjalës poetike.

Shprehja e këtyre komplekseve me përvojë universale psikologjike është ajo që të shpie tek pena e imagjinatës poetike. Kjo është sikur një e prekur thelbësore, ku luhet ndjenja dhe fshihet imagjinata për të gatuar mes vargut dëshirën e tjetrit. Poeti me poezitë e lart cituara, tregon në vetën e parë për të tjerët dhe përcjell konfigurimin e dëshirave thella, mes një imazhi të errët e të fshehtë në art.

Brenda këtij koncepti dhe nën ndikimin e teorisë së Martin Heidegerit poezi të tilla mes imagjinatës funksionojnë si perceptime logjike dhe kryejnë në fshehtësi "lirimin e tensioneve në mendjet tona".


Vijon ne numerin tjetër...

SHPIRTI I LIRË GJITHASHTU KA NEVOJË PËR HAPËSIRË VLONJATE, LABE

Unë i dua rrugët. Ato janë si jeta. Pavarësisht gjatësisë së tyre, kilometrat kalojnë dhe rrokullisen. Brenda tyre edhe vetë sekondat kanë vite që mund t'i ndjesh vetëm. Mund ti ndjesh sipas peshës së lodhjes së akumuluar. Është e rëndësishme të zgjedhësh drejtimin. Dhe e kupton nëse është vetë drejtimi, ai i duhuri në momentin e mbërritjes, kur destinacioni i dëshiruar shtrihet para teje. Ndonjëherë, ashtu thjesht me plot surpriza të mira dhe të këqija, me kujtime të afërta dhe momente emocionuese. Si e ardhmja, për të cilën të gjithë guxojmë të shpresojmë se do të jetë e lumtur, pa e parë se është vetëm një tjetër e panjohur e pavetëdijshme, që kryqëzon memorjet me të shkuarën, të tashmen e të ardhmen. E kjo është si një lotari. Si një lotari, ku ti e ke shpresuar produktin e saj fitimmadh, por në një rast e ke mirëkuptuar se ai është thjesht një baladë. Një baladë për ekzistencë, për shpresë...

Dhe kështu, në lotarinë e mbushur me ekzistencë, unë zgjedh Vlorën, i udhëhequr nga kurioziteti i moderuar i lojtarit që vë bast çdo javë me shpresën sekrete për të marrë një çmim jetik, që i duhet një pushuesi, të gërryer nga talenti, pena, mendja dhe aftësia për ta bërë këtë një model. Dhe unë kam nevojë për të. Pikërisht tani, kur thelbi im është i mbushur si një çantë e konsumuar plot me shkrime, nënvizime, mendime, kërkime, hulumtime, risi e letërsi. Kjo çantë harron rrobat e saj të destinacionit pushues. Rrobat e rrudhura të së vërtetës së zhveshur se edhe shpirti ka nevojë për hapësirë...

- Por pse nxitohesh kaq shumë për të shkruar për Vlorën menjëherë, një autor shkruet libërash në shëtitoren e mbushur me pushues nxjerr vokalin në pyetjen e tij, pi një kafe në një nga kafenetë që mbushet e zbrazet rishtas, dhe më duket sikur qyteti kurë nuk do të të shpëtojë nga disa tipa. Epo, erdha këtu dyzetë e pesë vjet më parë dhe ende nuk mund të iki nga ai kënd i rinisë sime me një transmetim të thjeshtë dashurie me dashurinë në krahët e mi. Të gjitha të tjerat janë lirika deti. Lirika të tilla të shkruara nga Arapi, ai Fatos i Madh me stonacionin lab, kalkulon shpirtun tek notat e mjaullimit



në zërin e Adriatikut, si dhe ajri i një të dashuruari të dorëzuar nga epoka e Fellinit , zbutin një përtaci të harruar në entuziazmin tim të rreptë turistik. Atmosfera e banesës sime të përkohshme më mbështjell me luks lab, ku nga fotografitë në mure, bukuroshet vlonjate dhe mitike më duket se ende joshin afgallët naivë midis arabeskave të kohës me trëndafila joshës. I tunduar, por jo i lëkundur, e refuzoj ftesën e mikpritësit me një mirësjellje të fituar angleze në një botë të trazuar Lindje-Perëndim. Nuk dua të zhytem pas tendave të Sheherazadës , por ta ndiej qytetin. Ta ndiej, sepse sytë thithin pamjet, por vetëm zemra i kupton mesazhet e

tyre të vërteta. Ashtu si në atë shëmbëlltyrë të shkurtër që më tregoi një mik nga këto vende. Një vlonjat i vërtetë zotëron tre mite. Një për miqësi, një të dytë për pritje shoqërore dhe një të tretë, të padukshëm, me të cilin përqafon shpirtat e atyre që do. A do ta meritoj përqafimin e mitit të tretë?

Vlora qëndron para meje, një shtresë toke të krypur nga mitet, me pluhur organik që depërton në mure, një gjurmë e pashërueshme e tështimës gjigante të kohërave që lagen e falen tek Adriatiku. Dhe duket se e ka ngadalësuar ritmin e tij, i lodhur duke sulmuar, pushtuar dhe pështjellur këtë bukuri të brishtë, rezistente, monumentale , të krijuar jo për përkëdheljen e diellit, por për daltat e sedefta të detëqënies. Ngjitem rrugëve si baseta, i ngurtësuar në thellësitë e rrjedhave mitike të turistëve të kënaqur. Rehatia e jodit mund të ndihet vetëm kur të strehon në mbrojtje, nga era dhe të nervozuarit tipologjik të

Gushtit kur hedh shapkën e tij të zeze mbi Kaninë e mbi Karaburun, nga logjika e pashkrur, e jetës në det-tokë. Dhe vetëm në momentet e rralla, kur dielli i limontë zbut mbrojtjen e fasadave vlonjate, para syve të jugut shkëlqen bukuria e banorëve të tyre të gjallë, vlonjatëve, e atyre të ardhurve nga rrethnajat, të cilët kanë frymëzuar gjenet e paraardhësve të tyre të lashtë në udhëtimin mëngjesor. Rakia e prushtë në flokët e tyre, ngjan si një parfum i prodhuar enkas në këtë gusht, teksa zbrazet në gotën qelibar. Natyra e ngjyrës dehëse sundon tërësinë. E portokallta dhe e limonta shpërthen në të gjithë këtë qytet të

pabesueshëm dhe paqësor, në një shpërthim pasioni për ngjyrën e kuqe të ndezur të Flamurit dhe Sheshit të tij të Pavarësisë, ose thjesht si një ngacmim me grinë. Vlora është ndoshta qyteti i vetëm në botë ku njeriu i thjeshtë respektohet me këtë gradacion lab. Ai është fjalë për fjalë kudo, i ri apo i vjetër, një mik i çuditshëm me një urtësi e dashuri labe midis turmës uniseks, në të cilën pantallonat e shkurtra dhe minifundet përndryshe praktike për muajin e pushuesit janë vetëm një shprehje e shtesës së personalitetit. Vlonjati pëlqen të jetë i racës së pastër. Të mos ndahet nga identiteti i tij. T'ua shesë atë të tjerëve, ta transformojë atë në pëlhura, ngjyra, shije, aroma dhe muzikë që e bëjnë të sapoardhurin të dashurohet me ndryshimin e personit vendas, i cili i ka rezistuar pushtimit kulturor, presionit politik, recesionit dhe uniformitetit në të vetmen mënyrë të mundshme, duke ruajtur hapësirën e tij shpirtërore. Prandaj, kam ndjesinë se Vlora përqafon jetën brenda vetes përmes mitit të tretë, të padukshëm, nga parabola e mikut tim Fitim Haxhiraj, që mburret gjithnjë e më shumë me shkrimet e librat e të shoqes së tij shkrimtare, Mjeshtre e Madhe“, Vilhelme Vranari, por që tashmë në këtë kohë është e sëmurë dhe e pamundur të bëjë atë që ajo e ka në gen, shpirt e në traditë. E kudo ndjej risi shpirti që bëhen monumente si të ishin të gjithë Monumenti i Pavarësisë. Monumente të palëkundura... Monumentet e palëkundura të spiritualitetit lab janë mbjellë në forcën e qytetit si organe në trupin e një gjiganti kokëfortë që merr frymë, tërheq, përfshin dhe do përmes tyre botën e globalizuar, të gulçuar dhe të pangopur, të shtangur papritmas nga intransigjenca unike e këtij populli që këmbëngul të jetë vetëm dhe vetëm vetvetja...



Supermarketi jonë është një vend i përsosur për të gjetur ushqimin tuaj të preferuar shqiptar! Ne përdorim vetëm burimet konkurruese për të siguruar cilësinë e shportës sonë.



Oferta speciale dhe çmime konkurruese



MERRENI PRODUKTIN SHQIPTAR ORIGINAL!



151-155 BALLARDS LN, CHURCH
END, LONDON N3 1LJ



SALMAN ŞIRINGÜL

Arya

SUPERMARKET



Design: www.fjalaelire.com



159-160, Parrock Street, Gravesend,
England, DA12 1ER

SOLIPSIZMI ANKTHPLOTË NË POEZINË E SHPENDI HULËSI TOPOLLAJ

Të lexosh në të gjithë përmasën krijuese shkrimtarin Shpendi Topollaj, „harron“ se lexon në gjithënderje të fjalës respektuese poetikën e poetikës së veçantë. Në leximin tim të parë, e quajta „Ironia e moshës“ një „kryevepër“. Dhe mendoj kështu edhe tani. I vogël, i shkruar me delikatesë, me fjalë të thjeshta dhe një ndjesi të estetshme poezie, libri kulmon poetikën e Shpendi Hulësi Topollaj nga „Drejtësia dhe forca“, „Atyre që zbukurojnë jetën“, „Debat i pafund“, „U ringjall prapë dashuria“ dhe „Plaku dhe Vdekja“. Ai i rafinon fjalët dhe hesht deri në brishtësi. Ai arrin stilin përmes privimit. Një refuzim i të tepërtës, pastaj i të pranuarës përgjithësisht, pastaj (deri në një farë mase) dhe i të kuptuarës përgjithësisht, i gjithçkaje pa të cilën mund të bëjë. Ndërsa dridhjet për të cilat nuk mund të dyshosh mbeten, pjesët e besimit, pikat thelbësore të vetes: një tkurrje ndaj asaj gjëje më të rrallë për të cilën mund të jesh i sigurt. Kështu u shfaq „Ironia e moshës“, duke strehuar fragmentet e saj në solipsizëm ankthplotë. Mjaft poezi të këtij libri sikurse „Sfinks“, „Flet shpirti“, „Dhurata e Zeusit“, „Kasandra“, „Kudo me para“ apo dhe „Pëlhura që s'mbaronte kurrë“. Njëzet vjet duke endur ditë e natë/ me takt duke ju shmangur çdo trimi,/Odiseun duke prituri kaq gjatë,/Penelopë! Si s'tu sos durimi!“ krijojnë mjeshtërisht këtë solipsizëm fragmentar. Në fakt, poezitë, frazat dhe imazhet e librit janë fragmentare (dhe jo me pretendimin e të heshturës), tekstet e tij të çuditshme nuk mund të jenë „të njëjta“, por me shumë fjalë dhe lidhje më të qarta. Dyshoj se rruga drejt tij ka kaluar përmes një pune të pamëshirshme privimi, se shkurtësia e poezive të tij ka lindur për

një kohë të gjatë: disa libra të mëparshëm, fjalime dhe heshtje të panumërta, shfaqje dhe fshehje, për të arritur në atë ndjesi që, duke lexuar, arrijmë në fund të poetikës, ku ajo bëhet ekzistencë. Dhe nga ku fillon të flasë vetëm, sikurse tek „Kudo me para“: „Çdo shpirt pas vdekjes kur shkon/ drejt Hadit, teksa Stiksin kalon/ një monedhë në hyrje i pagon/ në dorë lundërtarit Karon.“ Edhe truku, i cili në një farë mënyre është diksursi i librit, është i pranishëm në të përmes simbolikave të tij. Në kulminacionet e shumë poezive, ato emërtohen me theks. Edhe në ato raste kur është edhe trupi, apo vetë jeta dhe ekzistenca. Por ai vetë nuk është aty. I gjithë trupi nuk është aty. Gjithmonë vetëm fragmentet dhe mendimet përreth tyre. Duke e refuzuar tërësinë si mbizotëruese, „Kali i pavdekshëm“ zbut frikën, i emërton ato thjesht, fragmentarisht - ndërsa i përjetojmë, gjurmon trajektore të habitshme midis tyre dhe strukturave të tyre. Asgjë më shumë. Lidhjet që mungojnë midis gjërave mbartin panikun tonë. Lidhjet që mungojnë janë ato që „Muzat që më frymëzojnë“ mbush me aludimet e tij. Lidhjet midis të prekshmes dhe të konceptueshmes, me kërcimet dhe paqartësitë e tyre natyrore, pa ndërmjetësime të shpikura. Fjalët dhe heshtjet, të kompozuar me një ndjenjë parësore të së shenjtës, tejkalojnë diçka të papërcaktuar përtej dhe fshehtas mbajnë papërcaktueshmërinë e saj. Dhe ajo vetëdije se gjithmonë ka diçka mbi ne (ndonjëherë mbrojtëse, ndonjëherë shtypëse), diçka më e madhe se pasionet dhe murmuritjet tona; se gjithmonë ekziston një përgjegjësi më e madhe para së cilës tërësia jonë është fragmente. Çfarë mbetet atëherë? Të shqyrtojmë gjërat e vogla, sipas masës së

mendimeve dhe përvojave tona, të melankolive dhe shpresave tona, jo të ideve, jo të fantazive, sepse çdo pafundësi qëndron. Dhe ky është moralizmi i pathënë i librit, të manifestojë vetëm atë për të cilën nuk mund të mashtrohet, në mënyrë që të mos mashtrohet: me një mall për minimumin ekzistencial të poetikës, me një gjest të vazhdueshëm përthithjeje, me një ndjeshmëri të tërhequr me përlulësi ndaj rrymës, gjithnjë vetvetaj, edhe kur rreket tek lirika Lasgushiane. Jemi të vegjël. Dhe të pambrojtur, na kujtojnë fjalët e Topollaj tek „Portreti im varur në mur“, diku para qartësisë së guximit, trimërisë dhe dinjitetit, para lidhjes së sigurt të arsyes, para plotësisë së emocioneve, para lidhjes së ndjeshmërisë së thjeshtë. Genie fragmentare. Ne pyesim me habi. Dhe tërhiqemi para përgjigjeve të padurueshme. Por ne jemi. Dhe kjo është guxim, trimëri dhe dinjitet. Sepse është komploti i jetës sonë, nga narteksti dhe nëntokatedralet, me ngjitjet në atë para-katedrale, në të cilën lutja ende tingëllon brenda nesh, jo me frikë, jo nga lart, jo e tepërt për fuqitë tona shpirtërore, por me pëshpëritjen e saj të ndërprerë, me zërin e të vegjëlve brenda nesh „Shoku i klasës“: jo gjithçka mund të thuhet me zë të lartë, jo gjithçka mund të thuhet në tërësinë e saj, jo gjithçka mund të thuhet. Fjalët e Shpendit kërkojnë territore të sigurta dhe të pagabueshme. Dhe ato rezultojnë të jenë të vogla, të çuditshme, të shpërndara, pjesë të tërësive të ndryshme. Fjalët e Topollaj, si rregull, zbulojnë. Kjo është arsyeja pse tekstet e tij janë të vështira për t'u kuptuar për disa, për të tjerët vetëshpjeguese: ato na kujtojnë fragmente ontike, prani të pavërtetueshme. Fjalët e tij zbulojnë gjërat e vogla, tronditëse që të gjithë



i mbajmë, por i fshehim, që nuk kemi dashur t'i dimë për veten tonë për aq kohë sa në të vërtetë nuk i njohim më. Me një drejtësi naive, „Ironia e moshës“ na përball me shkallën e tyre gjithëpërfshirëse, duke na kujtuar thjesht sa të vegjël jemi ne vetë, të matshëm me jo më shumë se ato. Dhe me trishtim të kontrolluar, ajo shpalos një plan ekzistencialist të vetëdijes. Personi tek „Ironia e moshës“ pranon në heshtje: më shumë për të cilën mund të shkruaj jam unë, por kjo unë nuk është as një e tërë, unë imja është pjesët e mia folëse, secila prej të cilave më përket në mënyrë të barabartë dhe nuk më përket mua. Një rrëfim i projektuar në imazhe fragmentare, të tndjeshme, por sensuale; në pulsime shpërndarjeje dhe mbledhjeje të vetes; në refuzime të qeta..., në mënyrë që aluzioni i qëndrueshëm ndaj poetikës të mbetet. Kjo, megjithatë, është shumë, shumë për substancën e saj të pakapshme. Është si ta bësh poetiken pa e prekur, si ta thuash pa e emërtuar. „Ironia e moshës“ ia del mbanë, pa asnjë ndërhyrje, vetëm me deduksione, derisa ta ndiesh veten në një hapësirë aludimesh, krejt e kundërta e pyllit të rrënjësor baudelairean të simboleve, derisa ta kuptosh se je në kufirin e të kuptueshmes, në një lloj eksperimenti se sa larg mund të çohet një shprehje pa u zhdukur kuptimi; derisa ta pyesësh veten se cili është minimumi i fjalëve që kanë kuptim...

SEKRETI I SHKRIMIT

Gjithnjë e kam një „sy“ më tepër tek fjalja e parë e shkrimeve, poezive, krijimeve të mia letrare. Gjithnjë e vë në përdorimin më profesional atë sy. Kështu më ndodh kur dua të fiksoj me saktësi, por dhe me orë, ditë, edhe javë të tëra atë nisje letrare. Dhe prej andej gjithçka vjen vetvetiu, gjithçka vjen si në natën e parë të martesës. Mendoj se ka edhe mendime dhe ndodhi të ndryshme, por kjo për mua është gjithnjë një respekt për natën e parë. Gjithnjë me nisjen e një romani, me fillimin e një libri, fjalja e parë është me atë sy, me atë ndjesi. Kjo, sepse fjalja e parë me të cilën fillon një libër është si shikimi i parë midis dy të huajve. Disa mendojnë ndryshe. Kjo është puna e tyre. Disa mendojnë se si ta mbyllin një roman, pa e filluar atë. Dhe kur gjejnë fjalinë e mbylljes atëherë fillojnë romanin, librin apo... Nejse kjo është punë oreksesh, problem individual.

Unë, po ua them që në fillim se, e shkrova këtë tregim pa e ditur se cili do të ishte fundi, pa synuar kurrë një fund specifik. E vërteta është se kjo histori nuk ka ende fund. Sepse fjalja e fundit duhet të shkruhet nga një bukuroshe që pashë një mbrëmje pranvere tridhjetë e gjashtë a shtatë vite më parë përmes dritës që lëshonte, aromës që përcillte tek unë vetë ajo dhe larushisë së luleve të një parku që mbart histori më vete në qytetin e trëndafilave, por që dukeshin të mefshta para saj. Kjo është sot gruaja që dua me të gjitha format e dashurisë.

Ajo kishte zëvendësuar aromën e pakrahasueshme të darëzonjave që mbushnin murin e gurtë, dhe buzëqeshja

e saj natyrshëm ishte sa mijëra shumëbojshe që më magjepsi aq shumë sa e shtrëngova fort në sy dhe nuk e lëshova më. E mora hua, sikurse merret një gonxhe fshehtas nga rrënja e saj. E mbaja atëkohë më pas me vete kudo. Nuk e di nëse është e mundur, të biesh në dashuri në një sfodn me lule që të trullosin, në një hapësirë që të çmend me buzëqeshje, pyes veten në këtë rrugëtim të gjatë, ndoshta dhe aq shumë të gjatë ndonjëherë them me vete. Sidoqoftë, ajo aromë, ajo buzëqeshje më frymëzoi të shkruaja një histori. Të shkruaja një histori në të cilën gjithçka është e sajuar, madje edhe vetë autori. E them këtë se edhe pse ekziston një rrugë, një aromë, një shikim, një buzëqeshje, një realitet, unë akoma jam në ditën e parë, në atë ditë të vërtetë...

Dhe pastaj ndërsa ndodhi, ashtu sikurse ndodh një diçka e pabesueshme, jeta ishte jo vetëm pjesë e jetës, jeta që hidhet në këtë histori është edhe pjesë e lapsit, edhe pjesë e letrës. Është e gjitha mes të vërtetës dhe trillit, është një e trill në thelbin e jetës. Një ditë më vonë, në një ditë muaji të bletërimit shkencor, sipa mjatprodhuesve, vërtet të ëmbël, ajo vajzë me buzëqeshjen e saj magjepsëse qëndroi para meje, sikur të kishte rënë nga qielli. Dhe gjëja e çuditshme dhe në të njëjtën kohë tragjike në lidhje me atë takim ishte se ajo kërkoi diçka që unë nuk mund t'i a jepja. Ajo kishte vetëm një dëshirë, ishte e fiksuar pas saj, ashtu si princeshat në përralla janë të fiksuara pas një dere të mbyllur, dhe pikërisht kjo dëshirë e saj ishte e pamundur të përmbushej. Apo ishte e kundërta? Që atëherë, kanë ndodhur shumë gjëra, si të

mira ashtu edhe të këqija, dhe unë dua të tregoj gjithçka. Të gjithë të vërtetën rreth gënjeshtrës.

Kjo është historia e vërtetë, dhe unë ju shkruaj si një mësues që emërohet për herë të parë në një shkollë, dhe duhet të shkojë në mësim të nesërmen, pa e ditur se si e qysh do të jenë nxënësit, si një i sëmurë që nuk e di nëse dielli do të lindë përsëri për të nesër, si një i dashur që e vendos gjithë zemrën e tij në duart e buta të një femre me shpresën e guximshme se ajo do ta dëgjojë. Kishin kaluar tre ditë që nga biseda ime me të. Më duheshin tre ditë për të shkruar fjalitë e para të kësaj flete, por pastaj papritmas gjithçka rrodhi me një shpejtësi marramendëse.

Në javët në vijim shkrova sikur të isha i udhëhequr nga një fuqi më e lartë, shkrova për jetën time, siç e kishte thënë botuesi. Tregova për barin në të cilin më kishte ardhur ideja gjeniale, për një fantazmë në korridorin e një shtëpie botuese, për një letër drejtuar një shkrimtari të vendit ku jetoja përkohësisht në kutinë time postare që e kisha hapur aksidentalisht dhe për gjithçka tjetër që kishte ndodhur gjatë atyre javëve emocionuese dhe unike.

Pushimet erdhën dhe ikën. Ia çova laptopin dhe shënimet e mia një shoku tim, ku kalova disa ditë pushime, dhe kur e gjithë familja u mbledh rreth tryezës së madhe në dhomën e ndenjes në prag të ditëlindjes sime, që përkon në një nga këta muaj të pushimve, duke lavdëruar zotin fshehtas ende me një pulë nga racioni i



familjes, që mbushte çikas në pjatat tona, nëna ime ishte e para që tha, me arsye të mirë, se kisha humbur peshë dhe se nuk po haja mjaftueshëm.

A hëngra ndonjë gjë gjatë atyre javëve? Mund të kem ngrënë, por nuk kam asnjë kujtim për këtë. Im atë më lejoi të shkoja me pushim deri në fund të gushtit, me një mision të veçantë, u tha të tjerëve, dhe unë zgjohesha në mëngjes, vishja diçka dhe shkoja me vështirësi në tavolinën time me një filxhan kafe dhe letrat me vete.

Nuk u përgjigja në telefon, nuk u përgjigja ziles së derës, nuk pashë televizor, gazetat ishin grumbulluar të palexuara në tryezën e kafesë pranë divanit, dhe ndonjëherë në fund të pasdites dilja në lagje për të marrë pak ajër të pastër dhe për të blerë gjërat e nevojshme. Nuk i përkisja më kësaj bote, dhe nëse do të kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi natyrore, nuk do ta kisha vënë re. Asgjë nuk më interesonte gjatë atyre javëve. Thjesht e dija se duhej të shkruaja. Qëndroja para pasqyrës së banjës, duke parë hutuar imazhin e një burri të zbehtë me flokë të çrregullt, që kishin filluar ta ndjenin rënien, dhe rrathë të errët nën sy. Nuk më bënte përshtypje...

IDEAL SERJANI PËRBALL POETIKISHT DHE METAFORIKISHT SHKRIMIN KRIPTIK TË SHPIRTIT POETIK

Emri i Ideal Serjanit nuk është i panjohur për ata që ndjekin zhvillimin e letrave shqipe në të katër cepat e Atdheut, po aq dhe në tërësinë krijuese, narrative, poetike shqiptare. Ai mbi të gjitha ishte dhe mbeti vëzhgues i sinqertë poetik. Që në kohën e studimeve të tij në Filialin e Gjirokastrës, gjatë studimeve të tij, një tjetër zjarr ndizet tek mësuesi i ardhshëm – poezia!... Nuk fillon një luftë, por lind një unitet midis penës dhe fjalës. Atë që mbetet e patreguar në shkrime të thjeshta, fjalët e shtojnë, por jo si përkthim, shpjegim apo ilustrim, por si vizion, filozofi, plotësim i ndërsjellë... Shikuesi qëndron para ideve dhe tematikave të tij me poezi të gdhendura në to. Ideal Serjani e ndihmon lexuesin të pastrojë zemrën dhe shpirtin e tij për ta perceptuar fjalën e Zotit si një kërkim të hershëm për të Vërtetën, si... vizion shpirtëror! Një tipar karakteristik i poezive të tij është metaforizmi i tyre i pasur. Lapidare dhe alegorike, ato flasin për një kulturë të lartë poetike dhe një qëndrim kërkues ndaj talentit, ambientit, njeriut, gjeografisë, traditës, mikut dhe tërësisë së ndërlidhur me të kundërtën. „Vij me nusen e natës“ (2025) nuk është lloji i njohur i librave të parë, që mbledh më të mirën që autori ka shkruar deri më tani dhe asgjë më shumë, pasi botohen pas vdekjes. Është padyshim fizionomik - si nga pikëpamja etike ashtu edhe nga ajo estetike. Më pëlqen përpjekja e Ideal Serjanit për të qenë të paktën pak më i mirë i lirë sesa e lejon koha aktuale „demokratike“ lirinë e njeriut. Dhe sipas mendimit tim, pikërisht në këtë „përpjekje“ qëndron vlera e vërtetë e librit, jo vetëm duke u mbështetur, por edhe duke u tretur në një

masë të madhe në problemet e përgjeshme të moralit të Njeriut të Lirë, i cili në fakt është vetvetiu tashmë i lirë dhe universal në tërë problematikën, diskursin që trajton dhe tërësinë simbolike të vlerës.

Dhe skicimet, shkrimet, trajtimet fabulistike të mrekullueshme të autorit, të cilat nuk e di pse, më referojnë te afresket e disa poezive të denja të Sarandës poetike, nga të cilat poeti-artist mund të jetë nisur, por ka shkuar më tej në lakonizëm dhe sintezë të vijës së prerë të mospajtit me realitetin. Si një diskurs më vete libri „Vij me nusen e natës“ i këtij poeti dhe artisti të fjalës lokale, përveç pastërtisë së vizatimit verbal dhe artistik, dallohet edhe nga diçka aq e rëndësishme sa edhe e rrallë, veçanërisht në vlerat poetike të atyre copëzave të botuara edhe në Londër tek „Fjala e Lirë“ dhe „Albanian Post“ prania e një kredoje morale mbresëlënëse, të cilën krahët kristalorë të harmonisë që mbretëronin në këtë shpirt të denjë poetik e ngrenë në njohuri poetike dhe filozofike.

Ideal Serjani ishte dhe mbeti poetikisht i vetëdijshëm për veten, për vendin e tij në mesin e krijuesve të Sarandës dhe ajo së cilës i është përkushtuar është aspirata - drejt përsosmërisë, për të arritur më të mirën si në jetë ashtu edhe në botën përreth tij. Poezitë e tij janë të lehta për t'u lexuar, janë të ndritshme, ato burojnë spiritualitet dhe thellësi. Disa kohë më parë, në një cikël poetik të tij, e numërova Ideal Serjanin midis të paktëve, për fat të keq, përfaqësuesve të të ashtuquajturës „poezi e thjeshtë dhe e sinqertë shpirtërore“, ose poezi të kthyer drejt besimit në të



famshmen preambulë për të qenë dhe mbetur Njeri. Në librin e tij të ri „Vij me nusen e natës“, dhe që do të pasohet së shpejti me tre të tjerë, Ideal Serjani ka kërkuar dimensione të tjera të territorit të tij, të njohura nga shkrimet, poezitë, krijimet e tij të mëparshme.

Në këtë libër të ri të poetit ekziston një temë tjetër kryesore: një temë që e emocionon thellësisht dhe sinqerisht atë - kjo është tema e krijimtarisë dhe fati i atij që guxon të krijojë sinqeritet në një shoqëri që jo vetëm që është shpirtërisht joshpirtërore e sinqertë, por predikon edhe shkatërrimin, dhunën, urrejtjen dhe hakmarrjen. Këto dy tema janë të ndërthurura ngushtë dhe dendur në një pjesë të poezive që përbëjnë librin „Vij me nusen e natës“, por dhe në një masë të madhe në ato që do të përfshihen në librat e tjerë.

Libri „Vij me nusen e natës“ mbart nëntokën e një erudicioni që nuk është i dukshëm, por është një pjesë organike e strukturës së poezive të tilla si „Kërsheiri“, „Nusja e Natës“, „Puthjet dhe Lotët“, „Nata dhe Dita“, „Dua të Jem“, „Lumi“, „Rëtë e Zeza“, apo dhe tek poezi të tjera si „Ankesa e Varreve“, „Fati Endacak“, „Një Vajzë e Re“, „Një Filxhan Kafeje“, „Rruga Drejt Evropës“, „Piramadat“, „Dita e Mirë“, „I Marri dhe i Zoti“ „Shejtanët e

Tregtarit“, „Sa Emra?“ e mjaft të tjera.

Ky është një libër me hapësirën e vet të dallueshme dhe specifike. Shumë gjëra në të çojnë në refleksim mbi arketipet, mbi substancat primordiale... Libri i Ideal Serjanit gjen organikisht vendin e tij në një rreth shumë aktual pyetjesh me të cilat përballlet poezia... Për mua, kjo përmbledhje poezish është një hap në rrugën drejt Fjalës. Fjala në përmbledhjen e tij të poezive nuk është në formën e tij, por në pyetjen kryesore që rrjedh nga secila poezi: „Kush jam unë?“. Kështu, ai bëhet një lloj Odiseu, i cili udhëton drejt sekreteve të jetës: gëzimeve dhe hidhërimeve të saj, kthesave dhe kthimeve të përgjeshme në rrënjë ose në afrimin me realitetin. Ideal Serjani krijoi, duke zbuluar vazhdimisht në poezinë e tij sekretin e ekzistencës... Sekreti është ushqim për poezitë e tij, por e lidh atë edhe me frymën e fjalës së shtrenjtë, është lidhja midis njeriut dhe qytetit.

Ideal Serjani në përmbledhjen e tij të re të poezive mbetet në atmosferën e një territori poetik, thellësisht të tijin, specifikisht personal, pafundësisht të vuajtur. Kjo është atmosfera e njerëzores, e të ngriturës shpirtërisht, e vuajtjes dhe ndriçimit të përthithur nga brenda...

TREGU I RIMODELIMIT ËSHTË VAZHDIMISHT AKTIV

Drejtuesi i Kompanisë së ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd" Gazmend Cufaj, që nga krijimi e në vazhdim të punës profesionale si edhe tani në vitin 2025 kërkon planifikim dhe ekzekutim të kujdesshëm, duke marrë në konsideratë trendet e industrisë, kërkesat ligjore dhe kërkesat e tregut. Fokusimi në fusha specifike si ndërtimi i qëndrueshëm, ose tregtia e specializuar me këtë përkushtim i ofron kësaj kompanie tashmë me ëmër, avantazhe konkurruese. Përdorimi i softuerëve modernë të menaxhimit të ndërtimit dhe strategjive të marketingut dixhital është thelbësor për efikasitetin dhe rritjen, sikurse citon drejtuesi i Kompanisë.

Duke menduar se sipas të dhënave specifike të kësaj

fushe, Industria e ndërtimit parashikohet të rritet në vitin 2025, me sektorë specifikë si banesat private dhe projektet e infrastrukturës që tregojnë



potencial të fortë, në fokus të kësaj kompanie është Qëndrueshmëria. Kjo e fundit ka një theks në rritje në praktikën e ndërtimit të qëndrueshëm, duke krijuar mundësi për kompaninë të mbetet faktor i specializuar

në ndërtimin miqësor ndaj mjedisit.

Duke parë se ërshtatja e Teknologjisë mbetet parësore, mjetet dixhitale si softuerët e menaxhimit të projekteve, softuerët e vlerësimit dhe sistemet CRM po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për efikasitetin dhe menaxhimin e klientëve të Kompanisë së ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd". Një plan gjithëpërfshirës është thelbësor për të përcaktuar qëllimet e biznesit, shërbimet e ofruara, parashikimet financiare dhe strategjitë operative. Kuptimi i rregulloreve lokale dhe kombëtare është thelbësor. Kjo përfshin regjistrimin e biznesit, lejet, sigurimin dhe pajtueshmërinë me standardet e sigurisë.

Eksploroni mundësi të ndryshme financimi si kredi, grante ose tërheqjen e investitorëve. Merrni në konsideratë kostot e fillimit që lidhen me pajisjet, sigurimin dhe marketingun fillestar.

Për këtë e të gjitha që qëndrojnë në vazhdimin përkushtues të Kompanisë për vitin 2005 është ndërtuar një ekip profesionistësh të aftë, duke përfshirë kontraktorë, nënkontraktorë dhe menaxherë projektsh, të cilët përputhen me vlerat dhe qëllimet e kompanisë së ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd". Tregu i rimodelimit është vazhdimisht aktiv, duke ofruar mundësi për kompaninë. Kompania e ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd" përqendrohet në praktikën e qëndrueshme të ndërtimit dhe metodat e ndërtimit me efikasitet energjetik.

BIG BOSS SERVICES UK LTD

BUILDING CONTRACTORS

Our services include:

- Guttering
- Painting
- Decorating
- Power Clean
- Scaffolding
- PVC Windows
- Loft Covation

- Plastering
- Carpentry
- Roofing
- Brickwork
- Tiling
- Kitchen Fitting
- Extensions
- Bathroom Fitting



**Thank you
so much!**

KONSULTIMI me ekspertët është
ZGJIDHJA MË E MIRË për ta
shmangur humbjen.

Gazmend Cufaj



big_boss_services_uk_ltd



BigBossServicesUKLtd



@BigBossServices

Tel: 020 8591 9198
Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474
Email: bigboss-services@yahoo.co.uk
website: www.bigboss-services.webs.com
UTR: 7168616298
CRN: 8344897
VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës,
Tiranë dhe në
zonën e Plazhit
deri tek Mali i Robit

Kontakto:

07883029474 dhe 00355685309800

RASHID KHAN AVOKATI PROFESIONAL NË NDIHMËN TUAJ

Jo të gjithë ata që diplomohen si avokatë mund të punojnë ligjërish si të tillë këtu. Ka një rregull dhe një ligj. Dhe kështu shumë shpesh jeta kthehet në një mënyrë të tillë që na duhet ndihmë ligjore. Në këto raste, ndoshta do të duhet të kërkonim ndihmë nga një avokat. Dhe ju e kërkonim atë. Por ne ju ndihmojmë, se ai është pikërisht ai që ju vjen profesionalisht në ndihmë. Është avokati Rashid Khan, një nga emrat më të njohur të profesionalizmit dhe çështjeve të emigracionit. Ai është njohës i mirë i shqiptarëve dhe problemeve të tyre. Ai është specialist i çështjeve të trafikimit njerëzor. Ai është njohës i shkëlqyer i situatave mbrojtëse për shqiptarët në emigrim. Me qindra raste të fituara. Me qindra raste familjesh të bashkuara. Me qindra femra të vendosura në jetën reale dhe normale. Ka raste në të cilat do t'ju ofrohet një avokat falas. Për shembull, nëse kryeni një krim dhe ndiqeni nga policia, shteti do t'ju ofrojë një avokat falas - zyrtar. Nëse doni të përdorni një ndihmë të tillë është një pyetje tjetër. Nga përvoja ime dhe përvoja e klientëve dhe të njohurve, në shumicën e rasteve me këta avokatë zyrtarë, një person duhet të mendojë me kujdes se kujt t'i besojë.

Nëse punësoni një avokat zyrtar dhe përfundoni "të ngrohtë", ose gjobiteni me mijëra paund, atëherë nuk do të keni paguar tarifën e avokatit, por dëmet tuaja do të jenë shumë herë më të mëdha sesa nëse punësoni dikë që do t'ju shpëtojë nga burgu, gjobat, problemet.

Le të themi se keni vendosur të punësoni një avokat, pyetja tjetër është se sa do t'ju kushtonte një i tillë. Për t'u bërë avokat dhe për të qenë në gjendje të ushtrosh profesionin këtu, duhen mbi 5

vjet studime, të ndjekura nga një stazh.

Pra, Jo të gjithë ata që diplomohen si avokatë mund të punojnë ligjërish si të tillë këtu.

Pikërisht për shkak të fakteve të lartpërmendura, shërbimet e avokatëve janë të shtrenjta. Lidhja, nga faqja e internetit e qeverisë, shpjegon qartë se si ndryshojnë çmimet e avokatëve.

Tarifa e avokatit varet nga përvoja, si dhe nga vendi ku ndodhet. Në Londër, për shembull, avokatët janë më të shtrenjtë, si dhe ata që kanë shumë praktikë dhe përvojë.

Tarifat e rekomanduara janë nga viti 2021 dhe siç mund ta shihni, avokatët e diplomuar me më pak se 4 vjet përvojë ngarkojnë në Londër me çmime prej 244 dhe 277 paund në orë. Çmime që mund të duhet të përfshijnë TVSH-në. Çmimet shkojnë deri në 512 paund në orë.

Nuk dëshiroj që askush të përdorë një avokat, por e di që nëse keni nevojë të përdorni një, ne mund t'ju ndihmojmë dhe t'ju lidhim me një të tillë.

Në varësi të llojit të shërbimit që ju nevojitet, mund të rezultojë që nuk do të keni nevojë të paguani paraprakisht për një avokat, por të përdorni ndihmën ligjore falas të zotit Rashid Khan.

Nuk dëshiroj që askush të duhet të përdorë një avokat, por e di se nëse keni nevojë të përdorni një, ne mund t'ju ndihmojmë dhe t'ju lidhim me një të tillë, që është kompania e zotit Rashid Khan, Rashid and rashid solicitors.

RASHID KHAN THE PROFESSIONAL LAWYER AT YOUR ASSISTANCE

Not everyone who graduates as a lawyer can legally work as such here. There is a rule and a law. And so very

often life turns in such a way that we need legal help. In these cases, you will probably have to seek help from a lawyer.

And you seek it. But we help you, because he is exactly the one who comes to your professional aid. It is lawyer Rashid Khan, one of the most well-known names in professionalism and immigration issues.

He is a good connoisseur of Albanians and their problems. He is a specialist in human trafficking issues. He is an excellent connoisseur of protective situations for Albanians in emigration. With hundreds of cases won. With hundreds of cases of reunited families. With hundreds of women settled in real and normal life.

There are cases in which you will be offered a free lawyer. For example, if you commit a crime and are pursued by the police, the state will provide you with a free - official lawyer. Whether you want to use such help is another question. From my experience and the experience of clients and acquaintances, in most cases with these official lawyers, a person should think carefully about whom to trust.

If you hire an official lawyer and end up "warm", or fined thousands of pounds, then you will not have paid the lawyer's fee, but your damages will be many times greater than if you hired someone who will save you from prison, fines, problems. Let's say you have decided to hire a lawyer, the next question is how much one would cost you. To become a lawyer and be able to practice here, it takes over 5 years of study, followed by an internship.

So, not everyone who graduates as a lawyer can



legally work as such here. Precisely because of the above-mentioned facts, the services of lawyers are expensive.

The link, from the government website, clearly explains how lawyers' fees vary.

The fee for a lawyer depends on experience, as well as where you are located. In London, for example, lawyers are more expensive, as are those with a lot of practice and experience.

The recommended fees are from 2021 and as you can see, graduate lawyers with less than 4 years of experience charge in London prices of 244 and 277 pounds per hour. Prices that may have to include VAT. Prices go up to 512 pounds per hour.

I don't want anyone to use a lawyer, but I know that if you need to use one, we can help and connect you with one.

Depending on the type of service you need, it may turn out that you will not need to pay for a lawyer upfront, but use Mr Rashid Khan's free legal aid.

I don't want anyone to have to use a lawyer, but I know that if you need to use one, we can help you and connect you with one, which is Mr. Rashid Khan's company, Rashid and Rashid Solicitors.

NË KANINË ME DASHURI ADRIATIKU

Alma dhe Dashi, dy pronarë të mirëfilltë vlonjatë të një vile elegante në zemër të Ujit të Ftohtë, qëndrojnë duke pritur me respekt ardhjen tonë. Mëngjesi organizohet në një verandë të shkëlqyeshme, të rrethuar nga lule të harlisura dhe një mjedis hipnotik me lule e gjelbërim, që shtrihet matanë rrugës së dikurshme të mbushur me shegë e ulinj, si një shpirt dragoi në një pasqyrë magjike. Luksi vlonjat, çam dhe elbasanas, disi patronizues, i mbushur me e lule dhe mini-fotografi në çdo dhomë, disiplinon heshtjen përreth. Çdo gjë është e matur në përsosmëri. Dhe informacioni turistik i shkurtër, pa emocione i përcjell me dashuri moshe nga Miranda që dëshiron të thkesoj zotësinë dhe edukatën e saj, dhe më pas rruga për tek çadrat, dhe shazllonët, të rregulluar në mjedisin detpritis për pushuesit. Mes aromës së kafesë dhe salçiqeve të pjekura, vizitori i arratisur ndjen se si Vlora e mirë është futur edhe këtu - në heshtje, pa mëshirë dhe... në mënyrë të pakthyeshme? Mikpritja është e dobishme. Nuk do t'ju habisë kurrë me pritje të panevojshme. Nën sundimin e saj tipologjik të

kulturave, bota zvogëlohet në madhësinë e një suvenirri kiç. Dhe përndryshe, jashtë, dita pretendon të drejtat e saj trashëgimore mbi Vlorë me një shkujdesje rrethore dhe një zemër të guximshme. Peceta të lehta, si fokë, megjulleshtrihen me hir mbi shpinën e dragoit të ujërave, të cilat ia kanë zvarritur sprovën e tyre shekullore durimit stoik të bregut. Një peshk vogëlush argjendi - shpata e ringjallur e ndonjë dinastie të harruar - ndan një valë platini dhe zhytet në thellësi, i ngatërruar në një ëndërr të një legjende, të zhdukur prej kohësh nga ritregimi. Jahte luksoze lëmojnë sipërfaqen e Adriatikut dhe shkumëzojnë gjurmë të reja në kohë. Kënaqësi të shkurtra, të përsëritura, me shije të lartë nga katalogu i mrekullive të arritshme, brenda mundësive të kujtdo që është i gatshëm të transformohet në një zotëri për disa ditë. Por e gjithë kjo është shpirtërisht e pamjaftueshme për ne që vijmë nga disa milje larg. Unë për veten time jam një konsumator i parëndësishëm. Dhe paguaj vetëm me buzëqeshje ose mall për njerëz të mirë. Rruga më përpin në arterien e saj antracit. Një ngjitje e gjerë,

me shpinë të hapur, shaluar në një qiell të mbushur me diell, ecën përkrah kuriozitetit tim drejt Kaninës. Rrëke kristali përhapin flokë të lagur mbi shkëmbinj me myshk. Zbritjet renore të errëta të klaneve të dendura të reve thërrasin me një të qeshur përçmuese të degëve ullinore dhe erës tipike të freskisë alla-Kaninonte. Jeta, dikur e braktisur në shpopullim, sundon tashmë me një refleks memorjesh në hapësirat e heshtura të Kalasë. Këtu nuk është tokë e lënë pas, e shkuara flet në shumë mënyra me të tashmen. E shënuar për ata që kalojnë nëpër bukuritë e Ballkonit të Vlorës, ajo mbyllet pas tyre në virgjërinë e saj të gjelbër dhe të papërpunuar. Shpirti i këtij vendi është i pathyeshëm. Diçka e egër, e pazbutur në aromën e saj bimore e magjeps të huajin me një iluzion delikat dhe mistik. Papritmas e kuptoj se më është lejuar këtu nga mëshira bujare e Kaninës, e cila nuk ka asgjë për të humbur nga kalimi i kalimshmërisë sime të kënaqur. Se më lejohet vetëm të udhëtoj në kujtime, pas udhëtimit të shkurtër përgjatë bukurisë së saj mahnitëse. Deti Adriatik të prek me të gjitha shqisat dhe përhap hapësirën e tij joshëse para syve të mi si një pistë drejt përjetësisë. Sipërfaqja e plumbit, shurdhuese e heshtur e blusë i jep fund të gjitha emocioneve të mundshme njerëzore. Një llogaridhënie rrëmbyese para zgjedhjes fatale midis jetës dhe rehatisë, pushimit dhe meditimit. Vija e horizontit është një kufi midis të dyjave - një teh ekzistence, që shkëlqen në diell me një thjeshtësi kureshtarë, si kamë.

Një vlonjat nga Skela, poet, prozator dhe publicist, i veshur me një ndjesi mikpritjeje, përkulet dhe prek ujërat e padepërtueshme me pëllëmbën e tij. Gjesti i tij duket riatual-letrar-fetar - respektues, si një ritual, i rilindur së bashku me trupin e tij prej bashkësie të së ujtës dhe të tokshmes përmes rrëmujës turistike të ekzistencës që i kanë dhënë kuptim pranisë së tij këtu dhe tani.

- A është vapë? - bëj pyetjen time të sjellshme, për të hequr tërheqjen magnetike të thellësive të Adriatikut.

- Jo - përgjigjet poeti Thodhori Baba - është gjallëruese! Më është dashur të udhëtoj botën për të kuptuar sa shumë doja të kthehesha në shtëpi!

Pastaj ai në heshtje tregon tabelën në kodër, aty ku ka investuar në atë që ai e quan më e mira për brezat. E kështu unë lexoj librin e tij të fundit me poezi, „Galaktika e Harresës“ ndërsa kujtoj poezinë e tij „Aty“: „Aty kisha fshehur kujtimet,/te dëgt e palmës së thyer,/aty ku numëroja pikat e shiut/mbi gjokosin tënd,/aty strukej dhe puthja e parë/nën dridhjet e lakuriqësisë.“

Pa e kuptuar kisha hyrë thellë në pushtetin e Adriatikut... Bregu është i mbushur plotë. Në përputhje me rregullat e turizmit të civilizuar, aty shkruhet: „Ju lutem hidhni mbeturinat tua në koshin e plehrave!“

- Sikur ta dinit se sa mbeturina kam sjellë nga jashtë vendit! - qesh i huaji në disa gjuhë. Ndërsa poti Baba na kujton se me poezinë e tij „Pak tokë“: „o sa shumë halle ka mbjellur ky shekull!“

Dhe sytë edhe tek plehrat më në fund...

Dhe çfarë mund të them? Pasi kam pastruar deponinë time personale të mbeturinave, po kthehem në vilën ku jemi akomoduar. Do t'i lë të gjitha aty. Para se të shkel në Longomare. Para se të kaloj pragun e Longomares....



SUPERMARKETI “HILAL” PËR TË GJITHË NE

Një nga supermarketet më në zë, ku mjaft shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare bëjnë blerjet e tyre të domosdoshme të ushqimeve, është dhe Hilal Supermarket që ndodhet në Kilburn High Road. Në këtë supermarket janë ushqimet që afrohen më shumë me ne. Ky supermarket me dëshirën e tij për të gjithë sqaron dhe një fjalë që ka hyrë më së shumti nga gjuhët e tjera.

Disa prej jush sigurisht keni dëgjuar se në produktet që i blejmë nëpër shitore mund të kenë përmbajtje jo hallall (haram). Disa prej nesh shikojnë me përpikshmëri përmbajtjen e çdo produkti që e blejnë. Shikojmë se mos ndoshta produktet përmbajnë alkool, mish derri etj etj. Tani flitet shumë edhe për një paletë tjetër të madhe produktesh që mund të përmbajnë sende haram. Prej tyre janë zhelatina (gelatine) dhe disa nga emulgatorët (E-numrat). Zhelatina është një produkt që përdoret në shumë produkte ushqimore. Përdoret në disa lloje të margarinave, si dhe në shumë ëmbëlsira, si psh. gumi bombonat (nga firma Haribo dhe nga firmat tjera), Resana, krem banane etj.

Sipas halal.de, 80% të zhelatinës që prodhohet në Europë prodhohet nga derri. Kurse sipas Ëkipedia 70% e zhelatinës në Europë prodhohet nga derri. Në Ëkipedia në gjuhën angleze është përqindja pak më e vogël, përshkak se aty përfshiet prodhimi në gjithë botën.

Pamarrë parasysh sa është përqindja, është e

mjaftueshme për neve që se paku ta vëmë në dyshim origjinën e zhelatinës. Kurse qytetari blerës që dëshiron të marrë ushqimin halal, duhet t'i mënjanohej sendeve të dyshimta, sepse ai i cili i largohet sendeve të dyshimta, i është larguar haramit.

Vërtet hallalli është i qartë, por edhe harami është i qartë. Ndërmjet tyre janë gjërat e dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dijnë. Kush m b r o h e t nga gjërat e dyshimta, e ka siguruar në pikëpamje të besimit dhe nderit, ndërsa kush ka rënë në gjërat e dyshimta, ka rënë në të ndaluarën, ngjajshëm sikur bariu, i cili e ruan kope në rreth vendit të ndaluar, në çast kopeja mund të ikë dhe të kullotë në të. Cdo sundues e ka vendin për të tjerët të ndaluar, kurse vendi i ndaluar i Allahut janë ndalesat e Tij. Në trupin e njeriut gjendet një copë mishi, kur ai është i shëndosh, i shëndosh është tërë trupi, kur ai priset, priset tërë trupi, Ajo copë mishi është zemra.



Në industri për ta ndihmuar dhe shpejtuar emulsionin, dmth përzierjen e ujit me vajin, përdoren disa substanca të ashtuquajtura emulgatorë. Gjithashtu edhe emulgatorët sikurse zhelatina përdoren me shumicë të produktet ushqimore. Keta emulgatorë në listën e përmbajtjes të ushqimit shkruhen me numra E XXX (p.sh. E 471, E 472 etj).

Një pjesë e madhe e emulgatorëve prodhohet prej yndyrësve të shtazëve. Në halal.de lista e emulgatorëve të dyshimitë

është e gjatë. Vlenë të përmendet se emulgatorët e lartpërmendur mund të jenë të prodhuara edhe nga bimët. Por për fat të keq nuk mund të dihet saktësisht se cilët emulgatorë prodhohen në këtë mënyrë. Keshtu që origjina e emulgatorëve është për momentin e dyshimtë.

Tek supermarketi “Hilal Food Centre” në Kilburn high Road çdo gjë është hallall dhe e kontrolluar, pasi zbaton me përikshmëri zgjedhjen dhe zgjidhjen e duhur të produkteve.

“HILAL FOOD CENTRE” NË KILBURN HIGH ROAD “SHTËPIA” E SHQIPTARËVE

Aka dikush tashmë nga shqiptarët e Londrës që nuk e njeh pronarin e “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road. Natyrisht që mund të jenë fare të pakët ata që nuk kanë bërë rrugëtimin e tyre në supermarketin në fjalë për të blerë ushqimet dhe produktet shqiptare, dhe që nuk e kanë ndjerë të flas

me ta si vëlla, si mik, si shqiptar i vërtetë. Ky është një fakt. Ky është një realitet. Dhe më tej sa herë e kemi parë vetë këtë mik të singertë e të vërtetë të shqiptarëve që të u vij në ndihmë njerëzve të thjeshtë, vetë familjarëve.

Në një kohë të tillë kur çdo gjë shkon në rritje, kur çmimet të japin një tronditje, respekti i tij mënjanon fitimin dhe gjithnjë u bën ulje. U bën ulje dhe mikpritje. Është i tillë i lindur nga vetë jeta, i rritur nga vetë eksperiencia. Ndaj ata që e njohin, dhe ata janë shumë e shumë gjithnjë thonë se e kanë vëlla, e kanë mik, e kanë njeri të zemrës së tyre. Kjo na bën të ndjejmë thellë respektin që

na shfaqet si një material i shtrenjtë i formës më të lartë diskursive.

Tashmë gjithkush e di se “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road është në kuptimin më të mirë figurativ “shtëpia” e shqiptarëve. E themi këtë se aty sipas proverbit shqiptar, “gjen dhe qumësht dallëndysheje”. Kjo gjithë nënkupton faktin se që nga krijimi, që nga fillimi i këtij supermarketi nën drejtimin

e tij kishte një pasqyrë të qartë të jetës shqiptare, të kuzhinës shqiptare, të nevojave që kanë familjet shqiptare në Londër. E kështu aty nis që nga kripa e mbaron tek produkti më i ri që prodhon e sjell në sy të shqiptarëve dita.

“Hilal Food Centre” në Kilburn High Road “shtëpia”

është një Realitet Shqiptar. Me optimizëm e doza inkurajuese çdokush tashmë vlerëson agrobizneset shqiptare me nota maksimale, duke i cilësuar impresionuese dhe mahnitëse, dhe për vetë faktin se ato janë burimi ku merr jetë kjo sfidë e madhe e ushqimit dhe produktit shqiptar që vjen e konsumohet në ishullin

të tjera, sidomos të Ballkanit. Ndaj është mirë që piku i sezonit të prodhimit të fruta-perimeve të shihet mirë nga instancat përkatëse që të ketë më shumë hapësirë ligjore dhe në Mbretëri të Bashkuar. Përsëmbull shalqin, pjepër, mollë, dardhë, fiq, rrush, domate, kastraveca, kunguj, patëllxhanë e spec,

mashurka e bamje shqiptare nëse do të hynin në sezon në Londër natyrisht do të ishin një nga pikat ku do të sfidoheshin dhe më të fortët. Të gjitha këto fruta e perime janë pjesë e menusë sonë të përditshme, ndaj duhet me patjetër që të krijojnë udhë të reja ligjore drejt Britanisë.

Duke parë faktin se nga viti në vit, prodhimet shqiptare të fruta perimeve po shndërrohen në më të kërkuarat e tregjeve europiane për shkak të cilësisë së certifikuar të tyre ashtu si edhe shijes së vërtetë të tyre, ato duhet të jenë padyshim dhe në Britani të Madhe. Kur dihet fakti se eksporti i fruta-perimeve shqiptare (megjithë luftën për konkurrencë nga vendet fqinjë të

Shqipërisë) është konsoliduar dhe sa vjen e rritet, në tregun e brendshëm shqiptar ka një kaos përsa i përket vendeve ku shiten prodhimet vendase dhe ku është më e garantuar cilësia e tyre, ndaj duhet parë mundësia e lidhjeve tregtare jashtë, sidomos në BM. Kjo do ta shtonte akoma më shumë lidhjen e padiskutueshme tashmë të shqiptarëve me “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road.

Hilal Food Centre mbetet preokupimi im komunitar, vendi ku ushtroj më të mirën e mundshme që të zbatoj parimin. Eshërbimit të kulturuar, vlerës dhe respektit. Është supermarketi ku natyrshëm do të gjeni më të mirën e kërkuar, duke konkuruar e duke u përkushtuar.

Mirë se vini!

Investoni kohën tuaj me mençuri, është burimi i vetëm që nuk mund ta rimbushni



e shqiptarëve është një “Shqipëri e Vogël” në qendër të Londrës, ku ushqimet dhe produktet shqiptare konkurrojnë në cilësi e çmime me të gjithë produktet e tjera të Botës. Pra, produkte ‘Made in Albania’ janë prej vitesh tek “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road. Për shqiptarët e Londrës, dhe të Britanisë së Madhe, disa vjet më parë, do të ishte një Ëndërr Britanike, por për britanikët duket se

Britanik.

Krahas kësaj duhet shtuar se vetë Produktet Cilësore Shqiptare Rrisin Reputacionin e Shqipërisë në Britani të Madhe, pasi tek ky supermarket nuk janë vetëm shqiptarët që kërkojnë produkte cilësore shqiptare, por dhe etnitetet e tjera, ashtu sikurse ndodh që vetë shqiptarët në jo pak raste shijojnë dhe kërkojnë të provojnë produkte të shteteve



 **SUPERMARKETI**
I SHQIPTARËVE

HILAL FOOD CENTRE

PAMJA E RE 2025

Supermarketi me produktet,
çmimet, vlerat, cilësinë e
ushqimeve, produkteve, mishit,
vezëve. Konkurren kudo!



Supermarket
special



Kontakto
02073721059



Email
INFO@HILALFOOD.CO.UK

MIRË SE VINI

